Biblioletra

REVISTË E BIBLIOTEKËS KOMBËTARE DHE UNIVERSITARE TË KOSOVËS

VITI 7 • NUMRI 1 • 2010



KUVENDI FRANÇESKAN DHE NJERËZIT E TIJ TË SHQUEM

AT ZEF PLLUMI

Me shpalljen e Pamvarësisë së Shqipnisë në vitin 1912 lindte nevoja për nji ngritje të madhe kulturale, e cila do të përcaktonte shkëputjen reale të kombit shqiptár nga dominimi shekullor aziatik, për t'u kthye përsëri në gji të popujve europjanë. Shteti, edhe po të donte, nuk e kishte nji mundësi të tillë për mungesë të personelit adapt, mbasi intelektualët ishin tepër të paktë, e shumta që kishin krye shkollat e Perandorisë Turke për gadi ose mâ e shumta për oficerë, dhe nji pjesë tjetër shumë e vogël që mund të kishte pasë ndonji bursë nga rrethet socialiste antiklerikale të Francës ose të Italisë, ndërkohë që kleri katolik kishte në dispozicion nji sasi të konsiderueshme intelektualësh të shkolluem kryesisht në Austro-Hungari. Këta kishin pregatitun në heshtje të plotë, që nga mbarimi i shekullit të kaluem, e aq mâ tepër në fillim të këtij të njizetit, institucione kulturore të tyne, siç janë biblioteka, arkive, muzeume, tipografi e shtyp, banda muzikore e grupe teatrale dhe së fundi, përveç shkollave fillore edhe atê tregtare e qytetase.

/ vijon në faqen 6/

JAVA E BIBLIOTEKËS NË KOSOVË 2010

Biblioteka Kombëtare dhe Universitare e Kosovës dhe Ambasada Amerikane në Prishtinë, nga 12 deri më 17 prill 2010, organizojnë Edicionin e tetë të Javë së Bibliotekës në Kosovë.

Manifestimi qendror mbahet në Prishtinë, ndërsa që përcillet edhe me aktivitet edhe në qytetin e Prizrenit dhe të Gjakovës. Gjatë Javës do të organizohen aktivitete të rëndësishme, si: ligjërata të veçanta: nga fusha e bibliotekarisë, e trashëgimisë kulturore të Kosovës, e arsimit, si dhe ligjërata speciale kushtuar jetës dhe veprës së Fehmi Aganit.

Gjithashtu, do të mbahen edhe promovime, ekspozita të librave të rrallë, të fotografive të vjetra, si dhe ekspozita të artistëve të rinj.

Në Javën e Bibliotekës në Kosovë merr pjesë Catherine Marsicek, Zyrtare për burime të informacionit për Austri, vende të Ballkanit dhe Kaukaz në Ambasadën Amerikane në Vjenë, e cila do të mbajë ligjërata me interes në fushën e bibliotekarisë. Po ashtu, me tema e diskutime, marrin pjesë edhe ekspertë-bibliotekarë nga Shqipëria dhe Kosova.

Gjatë Javës së Bibliotekës nënshkruhen marrëveshje të rëndësishme me IPKO-n për shërbime falas të internetit për biblioteka; promovohen projektet e Ambasadës Amerikane dhe të Prokredit Bankës për modernizimin e Bibliotekës Kombëtare dhe Bibliotekës

Universitare, ndërsa që Biblioteka Kombëtare e Shqipërisë do t'i dhurojë BKUK-së - të plotë, revistën e digjitalizuar "Albania" të Faik Konicës.

Gjatë kësaj Jave, organizohet Dita e Dhurimit të Librit, si dhe mbahen debate e diskutime për projektet e të ardhmes së bibliotekave në Kosovë.

Në përmbyllje të Javës, organizohet koncerti me pianistin e njohur Desar Sulejmani, i mbështetur nga Ambasada Gjermane në Prishtinë.

Java e Bibliotekës në Kosovë pritet të evidentojë dhe të japë zgjidhje për shumë probleme që i përcjellin bibliotekat e tipave të ndryshëm në Kosovë është ngjarja më e rëndësishme e vitit për bibliotekat dhe kulturën në Kosovë.

Diana Topalli

Në këtë numër

BIBLIOTEKA DHE SHKENCA 3

SAMI FRASHËRI - FIGURË E SHQUAR E RILINDJES SONË KOMBËTARE 10

BIBLIOTEKA E ARTIT BASHKËKOHOR - PASURI BOTËRORE 14

BIBLIOTEKAT DIGJITALE TË MUZIKËS.....16

BIBLIOTEKA E UNIVERSITETIT AMERIKAN NË KOSOVË 20

SFIDAT E BIBLIOTEKAVE (NDËR)KOMUNALE.....24

LIBRI QË I MUNGONTE BIBLIOTEKARISË SONË 28

BIBLIOTEKA KOMBËTARE DHE UNIVERSITARE E KSOVËS
THE NATIONAL AND UNIVERSITY LIBRARY OF KOSOVA

www.biblioteka-ks.org

Botues: BKUK • **Kryeredaktor i botimeve:** Prof. dr. Sali Bashota
Kryeredaktor: Fazli Gajraku
Këshilli redaktues: Besim Kokollari, Bukurije Haliti
Realizimi kompjuterik: Hekuran Rexhepi
Adresa: Sheshi "Hasan Prishtina", p.n. Prishtinë
Tel: ++381 38 225-605, **Fax:** ++381 38 248-940 • **e-mail:** biblioteka@biblioteka-ks.org

BIBLIOTEKA DHE SHKENCA

(PËR NJË DIALOG MIDIS BIBLIOTEKAVE DHE INSTITUCIONEVE SHKENCORE)

SALI BASHOTA

PROBLEME DHE EVIDENTIME

Kosova në dy dhjetëvjetëshat e fundit të shekullit XX është ballafaquar me probleme të shumta dhe të mëdha në fushën e zhvillimit dhe të arritjeve kulturore, arsimore, shkencore, për shkak të represionit të vazhdueshëm serb në shumë drejtime, ndërsa edhe në dhjetëvjetëshin e parë të shekullit XXI, me gjithë përpjekjet institucionale nuk ka përparime të dukshme me projekte kapitale për investime në institucione të caktuara shkencore, as mbështetje konkrete në fushat e ndryshme të shkencës.

Institucionet që ushtrojnë veprimtarinë e tyre shkencore në Kosovë ende nuk kanë arritur të funksionalizojnë misionin e tyre në drejtim të afirmimit të shkencës në nivelin kombëtar, e mos të flasim për nivelin ndërkombëtar. Kjo është një temë më vete që kërkon një analizë dhe vlerësim objektiv.

Në Kosovë ndihet një mungesë e përfaqësimit të revistave shkencore përmes konsorciumit të bibliotekave elektronike në portalin e kompanive të ndryshme digjitale në Europë e më gjerë. Institucionet e arsimimit të lartë, të cilat e kryejnë funksionin mësimor, por edhe shkencor në shtatëmbëdhjetë njësitë akademike të Universitetit të Prishtinës ende nuk i kanë revistat e tyre shkencore sipas lëmenjve të caktuar, me përjashtim të katër-pesë fakulteteve. Kosova për arsye se nuk është anëtare e Organizatës së Kombeve të Bashkuara ende nuk e ka Agjencionin Kombëtar për Numrin Standard të Revistave (ISNN), i cili do të ishte anëtarësuar në institucione ndërkombëtare.

Prandaj, veprimtaria shkencore në institucionet arsimore, kulturore, shkencore të Kosovës kërkon një tretman tjetër. Edhe shkenca kolektive e tipit institucional edhe shkenca individuale. Gjithashtu, edhe tekstet universitare me përjashtime të vogla, ende nuk e kanë arritur nivelin e teksteve shkencore.

Shoqëria bashkëkohore e Kosovës duke i dhënë fuqi mendimit demokratik, gjithsesi, do të duhej të fuqizonte edhe më shumë mendimin shkencor, sidomos të gjeneratave të reja, të cilat do të afirmonin shtetin e tyre në tregun e dijes në kuadër të konkurrencës europiane e më gjerë.

INFORMACIONI SHKENCOR

Pa libra nuk do të kishte mendim shkencor. Bibliotekat kombëtare kudo në botë janë qendra të rëndësishme studimore, kërkimore, shkencore.

Bibliotekat janë institucione shumë të rëndësishme të shtetit, të cilat, ndër të tjera, ofrojnë edhe shërbime me karakter shkencor me literaturë studimore referenciale.

Bibliotekat kombëtare, bibliotekat publike, bibliotekat e universiteteve dhe ato shkollore, bibliotekat speciale etj., secila prej tyre përmes veprimtarive të caktura, mund të kontribuojnë në zhvillimin dhe afirmimin e shkencës.

Bibliotekat në institucione shkencore kanë karakter special, duke kryer shërbime për hulumtimin shkencor, jo vetëm në gjuhën amtare, por edhe në gjuhë të ndryshme të botës.

Duke bashkëpunuar me institucione të ndryshme ndërkombëtare për shkëmbimin e literaturës shkencore, përmes katalogut elektronik në internet bibliotekat bëhen qendra të promovimit të kulturave kombëtare edhe në shumë aktivitete me karakter shkencor.

Librat e vjetër e të rrallë, dorëshkrimet e vjetra e të rralla, si dhe dokumentet e tjera, madje ato unikate paraqesin një vlerë të jashtëzakonshme për studime shkencore.

Në Bibliotekën Kombëtare dhe Universitare të Kosovës veprimtaria e Qendrës Referale, si dhe koleksioni i punimeve të magjistraturës dhe disertacioneve të doktoratave ofrojnë informacione shkencore që mundësojnë njohjen me zhvillimin e studimeve në fusha të ndryshme të dijes.

Në epokën e digjitalizimit shumë institucione bibliotekare kanë krijuar konsorciume të bibliotekave elektronike në vendet e tyre. Revistat e njohura edhe në formë elektronike, të cilat janë me karakter shkencor mund të ndikojnë shumë në marrjen e informacionit për rezultatet më të reja në fusha të ndryshme të shkencës.

Biblioteka Kombëtare dhe Universitare e Kosovës e ka themeluar Konsorciumin e Bibliotekave Elektronike

të Kosovës dhe deri më tani ka ofruar shërbime efikase dhe të rëndësishme për t'u qasur në bazat e të dhënave elektronike nga kompanitë më të fuqishme në botë.

Bibliotekat e instituteve shkencore, të qendrave studimore, të akademive të shkencave etj., gjithashtu, duhet të kontribuojnë më shumë në zhvillimin e shkencës shqiptare me programe të reja, duke promovuar , në radhë të parë, përvojën e djeshme të shkencëtarëve të njohur dhe rezultatet e sotme të shkencëtarëve të rinj.

Në botë funksionojnë shumë shoqata dhe organizata, të cilat kontribuojnë në avancimin e shkencës përmes teknologjive moderne të komunikimit, duke i popullarizuar kontributet shkencore të shkencëtarëve.

Një kontribut të rëndësishëm jep edhe LIBER(Lidhja e Bibliotekave Kërkimore të Evropës). Në këtë lidhje janë anëtarësuar mbi 45 biblioteka kërkimore, në mesin e tyre edhe Biblioteka Kombëtare dhe Universitare e Kosovës që nga viti 2004. Kjo lidhje e bibliotekave bashkëpunon me Këshillin e Europës, Komisionin Europian, IFLA-n etj.

Aktiviteti përqendrohet në zhvillimin e projekteve kërkimore në Europë, organizimi i veprimtarive të përbashkëta, ruajtja e trashëgimisë kulturore europiane, gjithsesi, në avancimin e shërbimeve sa më efikase të informacionit më të avancuar shkencor.

Institutet bibliografike në kuadër të bibliotekave kombëtare, si dhe paraqitja e njësive bibliografike të librit shqip në Kalogun Botëror (World Cat) do të ishte shumë e rëndësishme për shkencën shqiptare edhe në relacione ndërkombëtare.

Veprimtari të ndryshme me karakter shkencor zhvillohen kryesisht në biblioteka kombëtare.

Biblioteka Kombëtare dhe Universitare e Kosovës ofron shumë



shërbime që kanë karakter shkencor. Biblioteka legatë e Fehmi Aganit dhe Biblioteka legatë e Krist Malokit.

Gjithashtu, edhe Biblioteka e Këndit Amerikan, Biblioteka e Artit Bashkëkohor etj., ofrojnë informacione dhe aktivitete të shumta karakter shkencor.

Në vitin 2008 në Bibliotekën Kombëtare dhe Universitare të Kosovës është themeluar Kujtesa e Kosovës, e cila është një qendër dokumentare që ka edhe karakter shkencor, ku grumbullohen të gjitha botimet në gjuhën shqipe dhe në gjuhë të huaja që flasin për Kosovën në periudha të ndryshme të zhvillimit të saj.

Manifestimi "Java e Bibliotekës në Kosovë" është një veprimtari e organizuar nga Biblioteka Kombëtare dhe Universitare e Kosovës dhe Ambasada e Shteteve të Bashkuara të Amerikës, e cila ofron aktivitete të ndryshme me karakter shkencor bibliotekar, sipas standardeve më të reja ndërkombëtare.

Konferenca Kombëtare e Bibliotekonomisë, e themeluar nga Biblioteka Kombëtare dhe Universitare e Kosovës dhe Biblioteka Kombëtare e Shqipërisë, është veprimtari e cila analizon dhe përgjithëson zhvillimet aktuale në shkencën e bibliotekarisë në nivel kombëtar dhe më gjerë.

Gjithsesi, puna shkencore duhet të zhvillohej në biblioteka shkencore. Bibliotekat shkencore dhe profesionale luajnë një rol të veçantë në zhvillimin e shkencës. Akademitë, institutet, arkivat, muzetë etj., pa llojin e bibliotekave të fushave përkatëse vështirë se do të mund të realizonin misionin e tyre kulturor dhe shkencor.

Në Kosovë biblioteka në shekullin XXI duhet të jetë më shumë në shërbim të shkencës, kulturës, edukimit, informacionit etj., për një zhvillim më të përparuar të shoqërisë bashkëkohore.

Besojmë dhe shpresojmë se drafti i Programit Kombëtar të Shkencës së Kosovës do të ofrojë një kornizë konceptuale për ngritjen e kapaciteteve shkencore në Kosovë, duke i përuruar vlerat kombëtare edhe në nivelin ndërkombëtar.

(Fragment nga kumtesa e paraqitur në aktivitetin "Java e Shkencës", Prishtinë, 1 mars 2010)

LIBRAT LETRARË NË KATALOGUN ELEKTRONIK TË BKUK-së

• *Këto të dhëna nuk japin pasqyrën e plotë të librave letrarë që ekzistojnë në Bibliotekën Kombëtare dhe Universitare të Kosovës, ngaqë shumë libra letrarë ende nuk janë përpunuar në katalogun elektronik të kësaj biblioteke.*

ADIL OLLURI

Katalogu elektronik është njëri nga shërbimet më vitale të Bibliotekës Kombëtare dhe Universitare të Kosovës, ku mund të merren informacione të sipërfaqshme për librat që ka BKUK-ja. Ky shërbim u mundëson qasje të gjithë të interesuarve për të marrë informata të sigurta se a është apo jo një libër i caktuar në këtë bibliotekë. Me njëfarë mënyre katalogu është një bazament i qenësishëm i portalit apo ueb-faqes së BKUK-së, e cila pa këtë katalog do të ishte e njëjtë, e varfër, sikurse shumë ueb-faqet e institucioneve të ndryshme kulturore, arsimore e qeveritare të Republikës së Kosovës.

Edhe pse është bërë një punë e lëvdueshme e punonjësve të Departamentit të Katalogimit të BKUK-së në klasifikimin lëndor dhe përshkrimin fizik të librave që gjenden në bibliotekën tonë, përmes programit ALEPH 500, që është një sistem unik bibliotekar, prapëseprapë ende ka shumë libra, sidomos botimet e mëhershme, të cilat ende nuk kanë hyrë në katalogun elektronik. Andaj, një statistikë e librave letrarë në katalog assesi nuk mund të merret si mostër e saktë për tërë librat letrarë që janë në Bibliotekën Kombëtare dhe Universitare të Kosovës, të cilët mund të jenë shumë më shumë në numër se sa që mund të jenë në katalog elektronik. Librat letrarë të pa kataloguar, lexuesit mund t'i gjejnë përmes skedarëve të vjetër, të cilët gjendën skaj hollit të BKUK-së.

Nga format dhe llojet e librave letrarë në katalogun elektronik të BKUK-së lexuesit më së shumti mund të gjejnë romane, 3744 sosh, ku prej tyre më së shumti ka romane të letërsisë shqipe. Këtu poshtë do ta japim të dhëna për romane të letërsive, të cilat janë më të pranishmet në këtë katalog: romane shqiptare - 1112; franceze - 1014; amerikane - 591; angleze - 246; gjermane - 174; italiane - 104; ruse - 77 etj.

Pas romaneve, pasojnë poezitë për nga numri, 3712 sosh, ku prej tyre, normalisht, lexuesit mund të gjejnë më së shumti libra me poezi nga letërsia shqipe - 2958; poezi serbe - 161; franceze - 92; turke - 84; angleze - 55; italiane - 42; amerikane - 36; gjermane - 33 etj.

Pas poezisë, për nga numri i tyre, lexuesit, përdoruesit, në katalogun elektronik të Bibliotekës Kombëtare dhe Universitare të Kosovës, mund të gjejnë novela, 1292 sosh: novela në gjuhën shqipe - 657; franceze - 130; amerikane - 124; angleze - 66; serbe - 59; ruse - 51; italiane - 29.

Në katalogun elektronik të Bibliotekës Kombëtare dhe Universitare të Kosovës, gjithashtu, janë të futura edhe një numër i konsiderueshëm librash letrarë me tregime, 1805 sosh: tregime shqipe - 931 libra; franceze - 161; amerikane - 158; angleze - 93; serbe - 79; ruse - 59; gjermane - 41; italiane - 37.

Po ashtu, në BKUK janë të kataloguara edhe një numër i veprave dramatike, ku në të janë të përfshirë 753 drama: drama shqipe - 327 libra; franceze - 147; angleze - 101; gjermane - 36; serbe - 12; ruse - 8; italiane - 8; amerikane - 7 etj.

Këto të dhëna statistikore, siç e thamë edhe më lart, nuk shprehin pasqyrë përfundimtare të librave letrarë që ekzistojnë në Bibliotekën Kombëtare dhe Universitare të Kosovës, ngaqë një sasi e madhe e fondit të librave letrar të kësaj biblioteke, që është pjesë e katalogut manual, ende nuk janë përpunuar në katalogun elektronik.

Këtu janë të paraqitura vetëm rezultate statistikore të librave të kataloguar deri më datën 6 prill, 2010, andaj, si të tilla, këto ndryshojë çdo ditë, ngaqë katalogu elektronik i BKUK-së vijon të mbushet me të dhëna të reja nga punonjësit e Departamentit të Katalogimit.

KUVENDI FRANÇESKAN DHE NJERËZIT E TIJ TË SHQUEM

/vijon nga ballina/

Si Urdhni i Jezuitve ashtu i Françeskanve ishin në garë më shoqishojnë për të zhvillue sa mâ mirë këto aktivitete në shërbim të popullit shqiptár. Mbas Luftës së Parë Botnore u duk sikur erdhi nji ças lirije veprimi, dhe menjiherë françeskanët themeluan të parin gjimnaz-lyce në Shqipní (shkollë e mesme kulturore të përgjithshme) në vitin 1921. Ashtu edhe Kolegja Saveriane e ndërroi profilin nga nji shkollë tregtare në nji shkollë të mesme klasike-kulturore së përgjithshme; po ashtu Motrat Stigmatine hapën të parin konvikt e gjimnaz vajzash. Nga këto shkolla mandej u dërguen ndër universitete të Europës për studime të nalta në mënyrë që u formuen rrethe intelektualësh të nji niveli europjan, pamëvarësisht se pushteti mbahej nga elementë feudalë, dhe kështu gjendja shoqnore e zhvillimi ekonomik i vendit njofti mjaft pak përparim, për mos me thanë aspak.

Në vitet tridhetë institucionet e klerit katolik shqiptár nuk paraqiteshin si ato misionet e vendeve të mbrapambetuna, por mâ tepër kishin pamjen e nji akademie shkencash, në të cilën bashkëpunojshin asat e kulturës e shkencës shqiptare. Revista Hylli i Dritës dhe Leka, zâdhanëse mâ të deja të kulturës shqiptare, i kalojshin edhe kufijt e atdheut: ndër to u botue së pari monumenti mâ i madh, kolosi i kulturës sonë popullore "Kanuni i Lekë Dukagjinit", i cili, ende sot, jo vetëm që nuk e humb vleren e vet, por mund paraqesë, sikur t'ish denjësisht i përpunuem, nji alternativë moderne të



Kolegji Saverian i Shkodres - 1928

rregullimit të asaj shoqnie njerëzore, që ka për ideal lirinë e barazinë.

Bibliotekat e Françeskanëve e të Kolegjës Saverjane kishin nji randësi të veçantë, dhe mund të numëroheshin ndër të mirat e Europës, jo për kah volumi, por për kah cilësia ndër të gjitha ato materje që i interesojshin kulturës shqiptare dhe ballkanike. Ndërsá "Arkivi i Provincës Françeskane" pothuej ishte unik në Shqipní. Fillimet e këtij arkivi mbërrijshin në vitin 1415, dhe kishin vazhdimësinë e dokumentave kishtare dhe shoqnore historike-ekonomike deri ndër ditët tona. Me interes ishte edhe "Arkivi i Arqipeshkvisë së Shkodrës". Mjerisht, të dyja këto mjaft pak të studiueme e të evidentueme, për mungesën jo vetëm të kuadrove punëtore, por edhe të mjeteve materiale. Megjithkëta ata që ruheshin më xhelozinë mâ të madhe, nga të gjithë anmiqtë e ndryshëm të njoftun të arkivave siç janë drita, teja, myku e vjedhja. Tue lanë m'anesh kultivimin e muzikës të organizueme gjysën e dytë të shekullit të kaluem në mënyrë të organizueme dhe që mbërrijti kulmin me veprat e Pater Martin Gjokës, nuk do qitë në harresë e as përpjekja e viganit të kulturës shqiptare, Fishtës, për me krijue nji pinakotekë me vlerë në Shqipní. Ai me vështirësi të mëdha ia kishte mbërrijtë me grumbullue rreth nja 50 kuadro antike, përgjithësisht te gjitha me përmbajtje fetare (ikona) të cilat i kishin teprue rrebeshit turk, por që mjerisht nuk mund i shpëtuen komunizmit shqiptár.

Gjatë luftës, sidomos ndër disa periudha anarkike të saj , kje mendue seriozisht për sigurimin e këtyre vlerave

kulturale: ato që mendojshin se ishin mâ te çmueshme, sidomos prej Muzeumit, kjenë paketue ndër disa qypa të mdhaje shtî në disa gropa të punueme në tokë për këtë qëllim. Edhe shumë kuadra antike me vlerë u ngarkuen për me i pshtue synit lakmues, por si u sollën motet, nuk u dijt gjâ kurrë për fatin e tyne, ndërsá pjesa kryesore, rreth 50, ishin të ndryme në nji odë të Kuvendit të rí ngjitun me arkivin, dhe nuk viheshin kurrë në ekspozim: këto mbaruen të gjitha se u çmojshin si orendi kishtare të pavlerë; un i kam pá ushtarakët me sytë e mi kah i shkallmofshin me kambë e i kanë trajtue si lecka për t'u hedhë ndër plehna, e ashtu u hodhën.

Biblioteka, sado që kishte disa ekzemplarë të rrallë e shumë të çmueshëm, nuk kishte mundësi me u lëvizë sepse binte në sy, mbasi ishte e njoftun prej shumkuj, dhe mjaft intelektualë vijshin e kërkofshin herë nji libër herë nji tjetër. Grushtin e parë ajo e pat vetëm në fillim të vitit 1945, kur nji ekip i njerëzve të kulturës, të ardhur prej Tirane, me listë në dorë, kërkoi fotokopjet e Buzukut dhe të Matrangës, Hahnin dhe nji sasi librash që i dijshin për mâ të çmueshmet; thane se ishin tue i marrë për Bibliotekën Kombëtare, dhe se duheshin vû në dispozicion të gjithë popullit e jo vetëm për nji komunitet të vogël siç ish Kuvendi Françeskan. Bashkë me Pater Aleks Baqlin, i cili i dorëzoi atâ ditë, ishem edhe un aty. Sigurisht që na u dhimbsën, por Biblioteka ishte aq e pasun me vepra tjera të rralla e të çmueshme sa mbetej gjithnji Bibliotekë e rangut të parë. Vetëm në vitin 1946 ajo pësoi fatin e Kuvendit ju thyen dyert e u plaçkit pa farë kriterit.

Arkivi i Provinçës Françeskane mund thom pa kurrfarë dyshimi se ishte pasuria mâ e madhe e kësaj gjinie në Shqipní. Ishte nji odë e madhe 10X5m ngjitun me zyrën e Provincialit, ngjitun ishte dhoma e ndërtueme për sekretarin e Provinçës, por që un gjithmonë e shifshim të pabanueshme. Simbas rregulloreve që kishim në arkiv nuk mund hinte kurrkush pa kenë i shoqnuem prej sekretarit, ose Provincialit vetë. Pothuej nuk i interesonte kurrkujt me hî mbrendë, sepse nuk e dite kurrkush se çka ishte aty. E kqyrshim me synin e nji enigme, porsi nji burg-kështjellë ku vuejshin bashkë të gjallë e të vdekur. Të parën herë kam hî në vitin 1942, kur isha ende student. Provincial ishte në atâ kohë Pater Anton Harapi. Kjo kje nji detyra të vogla, të cilat duhet t'i bâjsh pa lanë m'anësh mësimet. Do të vijsh dy herë në javë, me orar, për me shkrue korrespondencën e Provincialit derisá të vijë Pater Viktori". Ai më mësoi se si mbahej protokolli zyrtar, dhe mandej se si e ku vendoseshin në arkiv. Por kurr muer çilsat e hyme në atê dhomë enigmë ai më tregoi se nji pjesë fort e vogel me kapakë të mbyllun thirrej arkiv sekret", të cilin nuk kishte të drejtë me e hapë kurrkush, përveç sekretarit të provinçës e njerëzit e autorizuem prej nalt. Më bani me u betua se nuk do ta hapshim kurrë pa



BUSHATLÍT E SHKODERS 233

Bushatlít e Shkoders

Ktû âsht rendi t' i bâjmë të njoftun Bushatlít me fakte e dokumenta e pikë së pari po kallxojmë dý epizode qi dikuer kjene botue në të perkohshmen « Albania » [1] prej Z. Th. Ippen Konsull i pergjithshem i Austrís.

I. DOKUMENT

Nji misjon prej Austrije tu Pasha i Shkoders në XVIII qindvjetë

Kah mbarimi i të XVIII-të qindvjetë, Mehmet Pashë Bushatlija dijti me i a sigurue edhe të vetve kamben (zyren) qi, si sundimtár i vilajetit të Shkoders, la trashigim. Diq në vjetë 1770 i therun prej nji *jasakxhiut* [2] i cilli, per ordhen të Stambollës, kish per barrë me i dhanë dënimin qi gjygji i kishte pré. E këtë pse (në vj. 1768-1774) nuk pat marrë pjesë në luftë kundra Rusis.

rastësí e veçantë. Sekretar i provincës aso kohe ishte i emnuem Pater Viktor Volaj, por ai vazhdote universitetin për gjûhësi në Torino. Ndërkaq, Pater Antoni, si Provincial që ishte i nevojitej së paku nji që të rreshtonte me makinën e shkrimit dorëshkrimet e tija ashtu edhe korrespondencën zyrtare. Un në atê kohë e zotnojshëm mirë daktilografinë, i kishem shtyp disa artikuj, si edhe "Valë mbi Valë". Nji ditë prej ditësh më thirri në zyrë e më tha: "Shif, due me të ngarkue me disa kenë i urdhnuem. Tue dijtë se gjithmonë kurioziteti don me i dijtë sekretet un e pveta me singeritet: "E çfarë sekretesh mund ndryhen këtu?" Pater Antoni m'u përgjegj: Këtu përmbahen vetëm votat, votimet sekrete që fretnit i bajnë ndër mbledhjet e zgjedhjet e veta! Edhe atëherë m'u duk qesharake e bana buzën në gaz, ndërsá ai më tha: "Ti nuk po i jep randësi fare, por ndër komunitete kanë randësi të madhe, sepse po të njihen ato, lindin edhe grindje e shkaktohen paknaqësi. Për

disa kohë kur hijshme në arkiv m'u dukte se hyjshem në nji vend misterioz; kishem krijue në imagjinatë sikur aty bâjshin roje gjithmonë engjujt e djement bashkë, prandej kur dojshem me depozitue ndonji letër shkojshem drejtë e te vendi që e dijshem se ku âsht; mandej kthejshem pa lëshue sytë këndej e andej e për deret e jashtë, të cilën e sigurojshem mirë me kyçat. Por mbas disa kohe ajo odë u bâ gadi si e imja, nuk pata frikë mâ prej saj, por filloi kurioziteti. Nji ditë mora nji dosje dhe e hapa. E para ishte nji letër e vjetër e shkrueme italisht që pak a shumë kishte ketë përmbajtje:

"Shumë i Nderti Pater Prefekt, po më duhet me ikë pa pritë pa kujtue për me shpëtue kryet. Mbasi nuk e di çka ndoshë mbas ikjes sime po të tregoj se te shkallët e leximit të Ungjillit, nji metër larg lterit, po shtie në dhé nji metër thellë të gjitha paramentat, dy kelshejtat dhe librat e mi, Po nisem natën së bashku me x nëpër Mal të Zí. Në mos shpëtofsha thueje nji uratë për mue ti edhe të gjithë vëllazënt. Paqë e të mira! Fra Erasmo da Banjo."

N'atë ças kjesh mâ fatlum se ai peshkatari që më nji grep të vogël kapë nji peshk të madh. Me nji të shtrime doret e un u hodha në kohnat legjendare të Karamahmud Pashës. Po sikur të kishem guximin me i shfletue tjerat? Ato nuk ishin sekrete. Megjthkëtë kishem nji frikë të mbrendshme me i prekë pa leje; engjujt e djement ishin aty që ruejshin arkivin. Kur u pashë me pater Antonin për me dorzue çilsin e pveta: a kam leje, kur kam kohë, me kqyrë se çfarë dokumentash janë në këtë arkiv? Për ato sekretet nuk bâhet fjalë, por për të tjerat. "A din si âsht puna, - më tha, - arkivi për me u lexue âsht, porse duhet me ditë me e lexue. Kjo âsht kompetencë e historianëve, un për vedi, nuk di me i lexue; âsht punë për Pater Marinin etj. Ka gjithfarë stile shkrimit aty që njeriu nuk i merr vesht fjalët e shpesh herë as germat, çka po të duhet me u ngatërrue me



to, se mandej nuk e din kah me dalë. Jo që edhe të marrin shumë kohë e ty të duhet me studiue. Un të gjitha këto fjalë i mora sikur më jepej lêja me i lëshue synin arkivit. Edhe ashtu bana. Ndonjiherë fillova të marr ndonji prej atyne regjistrave të vogjël për me e deshifrue gjatë natës se ato germat stil mesjetar ishin nji problem që duhej shpërthye. Nuk gjeta vështirësi; mbas pak kohe u mësova. Sikur ma kishte thanë edhe Pater Antoni arkivi nuk ishte i rregulluem simbas nji kriteri shkencor, por pak a shumë simbas vjetve.

Aty e shumta e shkrimeve ishin në gjûhën latine edhe italiane, por nuk mungojshin as sllavet e sidomos ato me shkrimet turke. Regjistrat e shkruem turqisht ishin nji sasi aq e madhe sa nji ditë pveta se çka mund ishin ato. Pater Antoni më tha se ai nuk e dinte turqishten, por kishte gjasë që shumica do t'ishin regjistrat doganet ose hesape të tregtarëve të ndryshëm. Megjithkëta, tha, ndër ne po shuhet brezi që dinte turqisht, dhe vetëm për hir të arkivit âsht e nevojshme që ndonji të jetë i specializuem edhe në ketë gjûhë, mbasi kemi të përbashkët nji histori pesqindvjeçare.

Mbas pater Antonit u bâ Provincial Pater Maté Prendushi, i cili pat sekretar Pater Pal Dodajn. Ky në atê kohë ishte kund 67 vjeç, edhe pse mendjen akull, trupin e kishte të plakun. Arkivi kërkonte punë. Më thirri edhe ai e më tha:

- Un nuk di me shkrue me makinë,

besoj se nuk priton, kur të kemi nevojë, me m'i shkrue disa letra. Më kanë marrë në qafë tue më emnue sekretar në nji moshë kaq të shtyme.

- Nuk të kanë emnue për inát, iu përgjegja un, por ishte nevoja që në Këshillë të merrej edhe mendimi yt. Ti ke eksperiencë mâ shumë se kushdo tjetër.

Pater Palin unë aso kohe e kishem edhe profesor teologjije morale e juridike.

I thashë se e kishem për nderë me punue për Provinçën Françeskane.

- E di, më tha, ti je malësor dhe e mban besën.

Kur më thirri të parën herë edhe ky më bani me u betue në Ungjill se do të kishem për t'u ndejë besnik rregullave që kërkonte arkivi, dhe se kurrë nuk do të flitshem mbi ato gjana të cilat un i merrshem vesht prej shkrimeve të arkivit, gjithashtu edhe betimin se nuk do të hapshem kurrë arkivin sekret. Kur i thashë se këtë betim e kishem bâ edhe nji herë tjetër ai më tha se nuk ishte nji gjâ e panjoftun, megjithëse gjithkush kishte heshtë, sepse ti je burrnue para kohe.

Pater Pali ndër ne konsiderohej si nji ndër baballarët e Provinçës. Nuk ishte nji njeri strikt i rregullave porsi gjerman, ai kishte nji tolerancë aq të madhe sa edhe shumëkush e quente si liberal. Edhe me të vërtetë ishte liberal në vështrimin mâ të mirë, kishte nji shpirt aq të gjanë që sado ta kundërshtojshe, ose edhe ta shajshe, ai rrinte i qetë, bilè dashamirës. Kishte urrejtje për të gjitha diktaturat, por sidomos për komunizmin. Nji ditë e pveta: fashizmi a âsht i mirë apo i keq? M'u përgjegj: âsht i mirë edhe i keq: kur ban mirë âsht i mirë; kur ban keq âsht i keq. Fashizmin, më tha, nuk e qiti Musolini, por djali im Ahmet Zogu kje para tij, që në Kongresin e Lushnjes. Musolini e përshtati në nji vend tjetër të madh dhe e pagëzoi. Kjo ishte që më prishi mue me Ahmetin, sepse kur veproi mirë e pëlqeva, por kur veproi keq nuk e pëlqeva.

Gjergj Fishta në bibliotekë

- Po pse aq i mendshëm ishte Ahmeti?

Ai, më tha, ishte shumë i mendshëm, megjithëse muer shembull prej Ataturkut. Janë njerëzit që i pjell koha e nevoja e popujve. Ky âsht nji fenomen historik i njoftun që në antikitet. Ndër krizat e mëdha, në momentin kur populli gjindet para dilemës të jetës ose vdekjes, instikti i autokonservacionit nxjerr nji "shpëtimtar", nji diktator, i cili për nji kohë të shkurtë e të caktueme ka fuqí të plota. Përderisá këto fuqí t'i përdorojë për të mirën e popullit, âsht i mirë; por kur këto fuqí mandej ai i përdoron për të mirën vetjake, atëherë bâhet i keq dhe mund e çojë popullin e vet në grykën e vorrit. Mjerisht tue kenë se të shumtën e herës u vërtetue ky fenomen, diktatura ka marrë vështrimin e tiranisë, se në vetvedi nuk kishte me e pasë.

(Artikull për nji Album gjerman: "ALBANIEN SWISCHEN KREUZ UND HALBMOND", 1998)

SAMI FRASHËRI - FIGURË E SHQUAR E RILINDJES SONË KOMBËTARE

(ME RASTIN E 160-VJETORIT TË LINDJES)

MR. SC. TAHIR FONIQI

PARATEKSTI BIBLIOGRAFIK

Vëllezërit Frashëri, prej më të vjetrit, Abdylit, deri te më i riu, Samiu, përbëjnë njërën prej kaptinave qendrore të Rilindjes Kombëtare Shqiptare, "një fenomen i rrallë në historinë botërore". Ata "jetuan dhe vepruan në një periudhë kur Shqipëria vuante nën robërinë shekullore osmane, nën zgjedhën e varfërisë, prapambetjes dhe paditurisë".

Sami Frashëri (1850-1904) shkollimin e fillon në vendlindje, në Frashër, në gjuhën joamtare (turqisht, arabisht e persisht). Si fëmijë, ai largohet nga vendlindja dhe vendoset në Janinë, bashkë me familjen, ku, në gjimnazin "Zosimea" të qytetit, mori themelet e formimit të tij intelektual, arsimor, politik, patriotik, në frymën evropiane. Por Stambolli është pjekuria e Samiut, ku ai u vendos më 1872.

Për shkak të ideve patriotike sulltani, Abdyl Hamiti e izolon Samiun në shtëpi, ku ai, vetëm dy herë në muaj, kishte mundësi të paraqitet në zyrën e tij. Me këtë sulltani mendonte që ta shkëpuste Samiun, si kryetar të "Shoqërisë së shkronjave", nga lëvizja kombëtare shqiptare.

Samiu njihej në Azi, Afrikë, Indi, Kinë etj. Ai këmbente mesatarisht 15-20 letra në ditë. Biblioteka e tij kishte 20000 libra, të cilat ai i blinte kudo, me çmime të shtrenjta.

Sami Frashëri përbën një institucion në vete.



Sami Frashëri (1850-1904)

VEPRA

Sami Frashëri shkroi mbi 60 vepra letrare, shkencore e historike, në gjuhën turke-osmane dhe arabe: drama, fjalorë, tekste shkollore etj. Ai shkroi edhe vepra kapitale, si "Enciklopedia e Historisë dhe gjeografisë", në gjashtë vëllime, ku Samiu punoi 16 vjet. Samiu shkroi edhe 6 vepra në gjuhën shqipe, si "Shqipëria ç'ka qenë, ç'është e ç'do të bëhetë", botuar për herë të parë në Bukuresht më 1899, pa emrin e autorit, për shkak të rrethanave politiko shoqërore të kohës. Në këtë vepër shprehen idetë e Samiut për një Shqipëri të lirë e demokratike. Po ashtu Samiu boton, në turqisht, edhe romanin "Dashuria e Talatit me Fitnetin", 1872. Pas këtij romani ai boton tri pjesë teatrore: "Besa ose mbajtja e fjalës së dhënë" (1875), "Zotëria Jahja" (1876), "Gave" (1876). Dramat e Sami Frashërit janë ndër veprat e para të letërsisë turke. Në dramën "Besa", me subjekt nga Shqipëria dhe personazhe shqiptare, vihen në pah vlerat e larta morale të popullit shqiptar.

Sami Frashëri ka botuar edhe shumë broshura me karakter shkencor: "Qielli", "Toka", "Njeriu", "Gratë", "Qytetërimi islam", "Mitologjitë", "Përsëri njeriu", "Gjuha", "Zëdhënësi i Lindjes", "Anekdotat" etj. Këto studime flasin për horizontin e gjerë dituror të Sami Frashërit.

Sami Frashëri kërkonte të armatosej populli me fuqinë e idesë së shëndoshë: "Fuqia e idesë, - shkruante ai, - hyn më fort në punë, se shpata e mprehtë". Ai ka shkruar një numër të madh aforizmash, si: "Nuk ka argëtim më të madh për njeriun se puna", "Bashkimi i ideve është më i fortë se bashkimi i shteteve, "Ne qoftë se ka dy filozofë që nuk gabojnë, njëri nga këta është eksperienca", "Njeriun e bëjnë të përjetshëm veprat e tij", "Mendimet më të larta gjenden në fjalitë më të shkurta", "Helmi më i rrezikshëm është hipokrizia" etj.

Deri vonë, lexuesi shqiptar, ka pasur pak libra në duar të këtij ideologu e veprimtari të shquar të Rilindjes shqiptare. Hapa me rëndësi, në botimin shqip të veprave të Sami Frashërit, bëhen më 1988, me botimin e dy vëllimeve (Vepra 1 e Vepra 2), të përgatitura nga Akademia e Shkencave e Shqipërisë, përkatësisht

botimin i 8 vëllimeve nga Rilindja e Prishtinës, Redaksia e botimeve, mes viteve 1978-1984: 1. Besa; 2. Shqipëria ç'ka qenë ç'është e ç'do të bëhetë; 3. Fjalë të urta; 4. Sami Frashëri: monografi nga Zija Xholi; 5. Shkronjëtore e gjuhës shqipe; 6. Dashuria e Talatit me Fitneten: roman; 7. Kamus A'Lam: (enciklopedia - pjesë të zgjedhuna); 8. Bibliografi e zgjeruar e veprave të Sami Frashërit, hartuar nga Zuber Hasan Bakiu (Kruja). Kjo kolanë është botuar në 5000 kopje.

Por botimi më i plotë deri më sot, shqip, i veprës së Sami Frashërit, bëhet më 2004, nga ShB LogosA e Shkupit, e cila boton kolanën në 20 libra, të cilës ia kemi bërë këtu edhe bibliografinë. Këtë botim e ka përgatitur për shtyp Focus Pro Shkup, ndërsa e ka shtypur Focus e Prishtinës. Kolana përbën 2779 faqe shtypi ose 174 tabakë.

KOLANA E VEPRËS (BIBLIOGRAFIA)

FRASHËRI, Sami

VEPRA / Sami Frashëri ; përgatiti për botim Zija Xholi.- Shkup : LogosA, 2004 (Prishtinë : Focus).- 20 vepra ; 19 cm

(Biblioteka : Botime të veçanta)

- Vepra 1 : Shqipëria ç'ka qenë, ç'është dhe ç'do të bëhetë : mendime për shpëtim të mëmëdheut nga rreziket që e kanë rrethuarë.- 133 f.

Dy fjalë për serinë e veprave të Sami Frashërit / Adnan Ismaili : f. 7-12.- Parathënie : f. 13-16

- Vepra 2 : Personalitetet shqiptare në Kamus Al-Alam ; [përktheu nga gjuha turke-osmane Mehdi Polisi].- 243 f.

Fjalori i termave : f. 205- 238

- Vepra 3 : Viset shqiptare në Kamus Al-Alam ; [përktheu nga gjuha turke-osmane Zyber Bakiu].- Dy fjalë rreth botimit të veprës : f. 7-8.- Pak fjalë për përkthyesin / Gazmend Muka : f. 9-14.- 297 f.

- Vepra 4 : Abetare e gjuhësë shqip.- 96 f.

Botuar për herë të parë në Bukuresht në vitin 1886.- Parathënie : f. 8-9.- Shënime bibliografike : f. 96

- Vepra 5 : Shkronjëtore e gjuhës shqipe ; [përgatiti për botim Anastas Dodi].- 175 f.

Botuar për herë të parë në Bukuresht në vitin 1886.- Parathënie : f. 7-8.- Fjalëtë e shkronjëtoresë : f. 172-175

- Vepra 6 : Dheshkronjë ; [përgatiti për botim Anastas Dodi].- 143 f.

Botuar për herë të parë në Bukuresht në vitin 1888.- Parathënie : f. 7-8

- Vepra 7 : Gjuha ; [përktheu nga gjuha turke-osmane Mehdi Polisi].- 106 f.

Parathënie : f. [7]-8

- Vepra 8 : Besa ; [përktheu nga gjuha turke-osmane në vitin 1901 Abdyl Ypi].- 179 f.

- Vepra 9 : Dashuria e Talatit me Fitnetin ; [përktheu nga gjuha turke-osmane Mehdi Polisi].- 137 f.

Me rastin e botimit të tretë : f. 7-8.- Me rastin e botimit të katërt / Redaksia : f. 9

- Vepra 10 : Fjalë të urta ; [përktheu nga gjuha turke-osmane Zyber Bakiu].- 209 f.

Dy fjalë për botimin e kësaj vepre / Botuesi. f. 7-8.- Pak fjalë për përkthyesin / Gazmend Muka. - f. 9-14.- Parathënie / Zyber Hasan Bakiu.- f. 15-18.- Treguesi i temave : f. 203-209

- Vepra 11 : Anekdota ; [përktheu nga gjuha turke-osmane Mehdi Polisi].- 178 f.- Paraqitje nga përkthyesi / Mehdi Polisi : f. 7-8.- Shpjegimi i qëllimit : f. 9.- Parathënie : f. 11-13

- Vepra 12 : Përpjekjet e heronjve në përhapjen e islamit ; [përktheu nga gjuha arabe Ismail Ahmedi].- 49 f. – Parathënie / Ismail Ahmedi.- f. 7-15.- Veprat e tjera të botuara të Sami Frashërit, autorit të këtij doracaku.- f. 48-49.- Veprat e pabotuara të autorit të këtij doracaku.- f. 49

- Vepra 13 : Qytetërimi islam ; [përktheu nga gjuha turke-osmane Mehdi Polisi].- 111 f.

Sami Frashëri në fushën e islamistikës / Mehdi Polisi.- f. 7-17

- Vepra 14 : Zëdhënësi i lindjes ; [përktheu nga gjuha turke-osmane Kristaq Prifti, Vexhi Buharja].- 179 f.

Parathënie : f. 7-9

- Vepra 15 Gratë ; [përktheu nga gjuha turke-osmane Hamdi Bushati].- 64 f.

- Vepra 16 : Qielli ; [përktheu nga gjuha turrke-osmane Mehdi Polisi.- 94 f.

Parathënie / Mehdi Polisi : f. 7-12

- Vepra 17 : Toka ; [përktheu nga gjuha turke-osmane Mehdi Polisi.- 94 f.

Parathënie / Mehdi Polisi : f. 7-10

- Vepra 18 : Njeriu ; [përktheu nga gjuha turke-osmane Mehdi Polisi.- 88 f.

Parathënie / Mehdi Polisi : f. 7-9

- Vepra 19 : Përsëri njeriu ; [përktheu nga gjuha turke-osmane Mehdi Polisi].- 121 f.

Parathënie / Mehdi Polisi : f. 7-11

- Vepra 20 : Mitologjitë ; [përktheu nga gjuha turke-osmane Mehdi Polisi].- 86 f., [7] fletë : dy fjalë për serinë e veprave të Sami Frashërit

Parathënie / Mehdi Polisi : f. 7-8

Këto vepra i kanë përkthyer shqip Mehdi Polisi, Zyber Bakiu, Abdyl Ypi, Ismail Ahmedi, Kristaq Prifti & Vexhi Buharaja dhe Hamdi Bushati.

PASURIMI I KOLEKSIONEVE TË BIBLIOTEKËS

LAVDIJE RRAHMANI

Pavarësish nga kategoria (bibliotekë publike, universitare, shkollore, speciale, kombëtare), efektiviteti i shërbimit të një biblioteke varet nga mënyra e organizimit të veprimtarisë së saj. Biblioteka organizon punën bazuar në rregulloren e saj. Kjo rregullore përcakton edhe zhvillimin dhe organizimin e koleksioneve si çështje me rëndësi në administrimin e shërbimit bibliotekar.

Termi "zhvillim i koleksioneve" i referohet procesit të zhvillimit sistematik të koleksioneve të bibliotekës në shërbim të studimit, hulumtimit, rekreacionit dhe nevojave të tjera të përdoruesve. Procesi përfshin selektimin dhe deselektimin e materialeve aktuale dhe retrospektive, planifikimin strategjik për pasurimin e vazhdueshëm dhe vlerësimin e koleksioneve për të determinuar sa mirë nevojat e përdoruesve.

Përgjithësisht, zhvillimi i koleksioneve përfshinë shumë aktivitete bibliotekare duke filluar nga selektimi i titujve për blerje deri te veçimi i materialit të pavlerë për tërheqje.

Koleksionet e një biblioteke përfshijnë burime që plotësojnë nevojat e përdoruesve të saj si nga përmbajtja ashtu edhe për nga forma. Krahas librit dhe periodikut, koleksionet bibliotekare përmbajnë edhe materiale të tjera të shtypura, si: harta, pllakate, botime muzikore, video e audio regjistrime, CD, DVD etj.

PROCESI I PASURIMIT

Procesi i pasurimit kalon nëpër tri faza: zgjedhja e materialeve dhe porositja, pranimi i materialeve, si dhe evidentimi i tyre si pronë e bibliotekës (përpunimi fizik).

Pasurimi i koleksioneve të bibliotekës është mjaft i kushtëzuar nga burimet buxhetore, derisa madhësia dhe cilësia e tyre duhet të reflektojë nevojat e komunitetit.

Biblioteka duhet të përfill me saktësi mundësitë financiare, prandaj nuk do të jetë e mundur të plotësohen gjithherë të gjitha nevojat e komunitetit.

Nevojitet kujdes i shtuar i punës brenda kornizave buxhetore që të plotësohen sa më mirë kërkesat e përdoruesve.

Biblioteka pasurohet në vazhdimësi me botimet e reja në përshtatje me profilin e bibliotekës. Numri i ekzemplarëve varet nga lloji i bibliotekës, numri i lexuesve dhe mundësitë buxhetore të saj.

Punonjësit e bibliotekës vazhdimisht përcjellin përbërjen e koleksioneve dhe evidentojnë mungesat që vërejnë në lëmi të ndryshme. Ata marrin shënime edhe nga opinionet e lexuesve për librat që nuk gjenden në bibliotekë dhe kështu bëhet plotësimi i koleksioneve me botimet e kërkuara. Kjo nuk është e lehtë për t'u realizuar, sepse ato shpesh nuk gjenden në treg. Në këto rrethana biblioteka duhet të shfrytëzojë marrëdhëniet e shkëmbimit midis bibliotekave dhe në ndonjë rast dhuratën nga persona privat.

BURIMET E PASURIMIT

Blerja:

Burimi kryesor për pasurimin e të gjitha llojeve të bibliotekave është blerja. Është me rëndësi të shfrytëzohet çdo burim informacioni që ka të bëj me botimet e reja, si: bibliografitë, katalogët e botuesve, bazat e të dhënave elektronike etj.

Pas analizimit të këtyre burimeve të informacionit, përgatitet lista për materialet që do të porositen. Lista e përgatitur krahasohet me të dhënat e skedarëve të bibliotekës, për t'u siguruar që libri që do të porositet nuk është në koleksionet e bibliotekës. Gjithashtu, kontrollohen listat e porosive të mëparshme, si dhe ato të librave të porsaardhura që ndodhen në procesin e përpunimit.

Ekzemplari i detyrueshëm:

Vende të ndryshme, në bazë të ligjeve dhe vendimeve të posaçme të qeverive të tyre, obligojnë botuesit e vendit të dërgojnë falas një numër të caktuar ekzemplarësh të botimeve të tyre në një ose edhe në disa biblioteka të vendit, një ndër të cilat është Biblioteka Kombëtare.

Ekzemplari i detyrueshëm e bën përgjegjëse bibliotekën kombëtare të një vendi të depozitojë dhe të ruajë të gjitha llojet e botimeve të vendit, duke krijuar në këtë mënyrë koleksionin arkivor të këtyre botimeve. Ekzemplari i detyrueshëm sot luan rol të rëndësishëm në krijimin e bibliografive kombëtare në shumë vendeve të botës.

Shkëmbimi i materialeve midis bibliotekave:

Bibliotekat veçojnë nga fondi i tyre libra që nuk i përshtaten profilit të bibliotekës, nuk kërkohen nga lexuesit ose janë në shumë kopje dhe krijojnë një fond për shkëmbim. Këta tituj në formë liste u dërgohen bibliotekave të tjera. Bibliotekat kanë mundësinë të zgjedhin tituj që u duhen.

Kështu realizohet një shfrytëzim më i mirë i literaturës në nivel vendi por edhe në nivel ndërkombëtar. Shkëmbimi është një metodë shumë efektive dhe për pasurimin me tituj në gjuhë të huaj nëpërmjet marrëdhënieve të bashkëpunimit që biblioteka vendos me biblioteka të vendeve të ndryshme të botës.

Dhurata:

Është një mundësi e mirë për pasurimin e fondeve të bibliotekës. Dhuratat mund të bëhen nga biblioteka, nga persona të veçantë dashamirës të librit e të bibliotekës, fondacione të ndryshme kombëtare e ndërkombëtare, organizata të ndryshme etj.

Duhet të tregohet kujdes i mjaftueshëm në seleksionimin e materialeve të dhuruara, duke u bazuar në kriteret që biblioteka ndjek për pasurim me qëllim që të mos dilet nga profili i bibliotekës dhe kërkesat e lexuesve.

BIBLIOTEKA E ARTIT BASHKËKOHOR - PASURI BOTËRORE

Biblioteka e Artit Bashkëkohor, e cila gjendet në Bibliotekën Kombëtare dhe Universitare të Kosovës, duhet të quhet, me të drejtë, Biblioteka e Artit Botëror. Për disa arsye, ndër to: sepse në ata libra që janë aty prezantohen piktorët realistë, abstraksionistë, hiperrealistë, ekspresionistë, postekspresionistë, pointilistë, romanistë, kubistë nga të gjitha vendet e botës, ata që i ka njohur dhe i njeh njerëzimi, d.m.th. që s'janë dhe janë bashkëkohorë, që kanë vepruar kaherë, që nga viti 1200 e më tutje, por dhe disa që veprojnë e veçohen sot për stilin, për mesazhet dhe për përzierjen e periudhave të arteve. Gjithë ai fond i madh për artet, veçmas për pikturën dhe skulpturën, ia shton vlerën BKUK-së, ngaqë aty janë artistët më të mëdhenj të botës, gjithashtu edhe studiuesit më në zë të arteve figurative

BERAT ARMAGEDONI

Biblioteka Kombëtare dhe Universitare e Kosovës, si cilido tjetër institucion kulturor bibliotekar mbarëkombëtar, që nga themelimi, është përpjekur që brenda departamenteve të veta ta ruajë dhe ta shtojë pasurinë bibliotekare të fushave të ndryshme, me libra të ndryshëm nga gjuhët e ndryshme të botës, me: libra për artet, për shkencat sociale e humane. Udhëheqësit e këtij institucioni, të vetëdijshëm që studentëve të Fakultetit të Arteve, profesorëve, studiuesve, artistëve dhe artdashësve u mungojnë librat për artet, sidomos ata për pikturë e skulpturë, në kuadër të kësaj Biblioteke



vitin e kaluar kanë hapur edhe Bibliotekën e Artit Bashkëkohor, në të cilën, në një sallë mbi 50 metra katrorë, kanë futur mbi 6 000 tituj të librave për artet bashkëkohore në gjuhën gjermane, pak në angleze, italiane e franceze.

Edhe pse ky është kontribut i madh i këtij institucioni për artdashësit, për të liruar atë sallë, madje dhe i dhuruesve e mbledhësve të atyre librave, është dhe një e keqe: aty për 31 ditë nuk mund të përshëndetësh as me 31 vizitorë. Ndodh që një ditë të vijnë tre-katër shokë përnjëherë t'ua lëshojnë një sy atyre librave, ashtu siç ndodh që tri-katër ditë të tjera më të mos shfletojë askush asnjë faqe.

Në librat e kësaj Biblioteke njeriu gjen, nëse ka interesim e kohë, pikturat dhe skulpturat që njeh dhe ka dëgjuar njerëzimi, madje dhe studimet për pikturat dhe skulpturat e piktorëve dhe skulptorëve më të famshëm në botë.

Kjo Bibliotekë Bashkëkohore (BAB) në këtë Bibliotekë Moderne (BKUK) ka: libra, revista, gazeta, partitura, katalogë të ekspozitave, letërkëmbime e dorëshkrime të librave të vjetër e të rrallë, CD, harta, fotografi, ekspozita individuale e kolektive etj. Në të, gjithashtu, ka: libra të përgjithshëm për artet, për dizajn dhe uebdizajn, libra teorikë për artin, libra komikë për artin, libra poetikë për artin, monografi klasike e moderne për artin, libra për muzetë e institucionet artistike më të përmendurat në botë, libra për historinë e artit, për fotografitë, për historinë e fotografive. Ka edhe pak libra për fotografinë e filmit, për filmin, për filmin fiksion dhe dokufiksion, për xhirimin e filmit, për mediet dhe semiotikën e medieve, diçka edhe për gazetarinë televizive.

Aty ka shumëçka. Secili libër ka vlera më shumë se tjetri. Por, ka diçka që s'shkon. Fatkeqësisht, akëcili nga këta konsumohet shumë pak. Librat janë të madhësive të ndryshme: 30x18, 25x25, 25x16, 20x14, 18x12, 10x10 e shumë e shumë të tjerë. Me këtë madhësi janë shumë të bukur. Kanë dizajn të bukur, kreativ, domethënës, realist e simbolik. Ka nga këta libra që peshojnë 100 gramë, por ka që peshojnë edhe katër kilogramë.

Pasi për çdo titull libri ekziston vetëm një ekzemplar, kjo Bibliotekë, ashtu sikurse e gjithë Biblioteka Kombëtare dhe Universitare e Kosovës, nuk lejon që libri dhe materialet e ndryshme të Bibliotekës të nxirren jashtë objektit. Ata që janë të anëtarësuar në këtë institucion, që janë lexues të saj, mund ta marrin librin dhe ta lexojnë e përdorin për

nevoja të veta vetëm brenda hapësirës së BKUK-së. E, nëse ai libër u duhet për kohë më të gjatë, atë mund ta rezervojnë edhe për ditën e nesërme, të pasnesërmen e më tutje. Ndodh kështu, për arsye se, këto biblioteka kanë fonde të rralla, për të cilat duhet kujdes më i veçantë, madje edhe këta libra të rrallë kushtojnë shtrenjtë. Libri më i lirë në Bibliotekën e Artit Bashkëkohor, që mund të blihet në treg, nëse gjendet, kushton 10-15 euro, më i shtrenjti deri në 300. Ka të tjerë që s'paguhen me para. Prandaj, edhe kujdesi për ta është maksimal, aq sa përkujdesja e prindërve për foshnjën.

Në shumë këta libra, veçmas në ata teorikë/studimorë, janë dhënë mendime të ndryshme dhe shembuj të ndryshëm për pikturën: realiste, abstraksioniste, hiperrealiste, ekspresioniste, postekspresioniste, pointiliste, romantiste, kubiste, në të cilat janë paraqitur motive nga bota e njerëzve, e florës dhe e faunës etj. Studime për fotografinë kolor dhe bardh e zi. Gjithashtu, në librat studimorë të autorëve gjermanë, anglezë, italianë e francezë janë veçuar jo vetëm kryeveprat e piktorëve më të mëdhenj botërorë, Mona Liza e Leonardo Da Vinçit, ambientet private të Ticianit, gravurat me motivacione Kundër Reformimit të Kishës katolike të Piter Paul Rubens, shpirtrat e gjallë (portretet) të Rembrand Van Rinit, postimpresionizmi i Vincent Van Goghut, kubizmi i Pablo Picassos, ekspresionizmi abstrakt i Jackson Pollockut etj., por dhe shumë piktorë të vjetër e të rinj, veprat e të cilëve janë studiuar në raport krahasimi me veprat e piktorëve: gjermanë-italianë-spanjollë-francezë-amerikanë-holandez-britanezë e ku dimë tjetër.

Aty, gjithqysh, bashkohen të gjithë të famshmit e botës, njëri përskaj tjetrit, të shpeshtën e herëve, si shembuj të marrë për të mirë, si kreatorë e ideatorë të historisë së njerëzimit, të luftës e të paqes, të mjerimit të theksuar dhe të pasurisë së madhe. Pra, aty janë të gjithë, ata që kemi mësuar për ta dhe për jetën e tyre, por dhe shumë të tjerë që nuk i njohim, e që do të donim t'i njihnim, të paktën ato kryeveprat e tyre të artit botëror, që jetojnë gjithherë.

BIBLIOTEKAT DIGJITALE TË MUZIKËS

EDONA MUNISHI – KOKOLLARI

VËSHTRIM I PËRGJITHSHËM

Bibliotekat digjitale, në përgjithësi, por edhe bibliotekat digjitale të muzikës në veçanti, janë një dritare e re shërbimesh informacioni përmes internetit. Ato veçse e plotësojnë, e përshpejtojnë dhe kurdoherë e vënë në dispozicion informacionin për përdoruesin e përgjithshëm ose të specializuar muzikor krejtësisht sipas dëshirës, kohës dhe nevojës së tij.

Për bibliotekat digjitale flitet dhe shkruhet mjaft shumë. Ato përkufizohen në mënyra të ndryshme duke tërhequr vëmendjen e studiuesve dhe praktikantëve të tyre drejt përgjithësimeve apo veçantive. Për këtë arsye e kemi parë të udhës që të japim në fillim disa përkufizime të bibliotekave digjitale për të pasur të qartë dallimin e tyre me ato tradicionale, por edhe për t'i kuptuar më mirë ato, pasi një përkufizim, në një farë mase, i vë edhe kufijtë e shërbimeve apo fushëveprimin e bibliotekave digjitale. Kështu, Federata e Bibliotekave Digjitale (1998) jep këtë përkufizim të bibliotekave digjitale:

"Bibliotekat digjitale janë organizata të cilat ofrojnë burime, kanë personel të specializuar për të për përzgjedhur, organizuar, ofruar qasje në burime intelektuale, interpretuar, shpërndarë, ruajtur integritetin, dhe sigurojnë jetëgjatësinë e koleksioneve digjitale, në mënyrë që ato jenë të gatshme për t'u përdorur nga një apo bashkësi të ndryshme".

Është e udhës ta interpretojmë përkufizimin e sapo dhënë. Dallohet qartë se bibliotekat digjitale kanë një përkufizim mjaft të gjerë sa i përket përmbajtjes të cilën e kanë, mirëpo fushëveprimi i tyre është i përkufizuar vetëm në botën e botimeve digjitale, e dhënë përmes konceptit të shprehjes "qasje në burime..". Dihet se fjala 'qasje' dhe 'burime' janë rezervuar kohëve të fundit mjaftë shumë në botën digjitale apo të internetit. Në këtë mënyrë, bibliotekat digjitale dallohen prej bibliotekave tradicionale. Përndryshe, përveç kësaj ane, anët e tjera të përkufizimit nuk dallojnë shumë prej përkufizimeve që jemi mësuar t'i shohim për bibliotekat tradicionale apo në misionet e vizionet e tyre.

Bibliotekat digjitale, temë e trajtimit tonë këtu, janë zhvilluar me shfaqjen e teknologjisë së kompjuterit. Megjithatë, ato duhet të nënkuptohen, në aspektin afatgjatë, si vazhdimësi e bibliotekave tradicionale, duke ofruar shërbime të informacionit në një formë më të ndryshme dhe më efikase. Në fazën e hershme të zhvillimit të tyre, ka filluar organizimi i përmbajtjes apo informacionit nëpër disqe të ndryshme, si CD, disketa, etj., atëherë të njohura si biblioteka elektronike apo edhe virtuale. Me gjithë se tentohet të ketë dallime, për qëllime të interpretimit më të lehtë, bibliotekat digjitale nënkuptojnë edhe bibliotekat elektronike apo virtuale, që ishin shprehje të përdoruar por që përdoren edhe sot e kësaj dite shpesh për të nënkuptuar po thuaj konceptin e njëjtë. Kështu, për bibliotekat elektronike, fjalori i biznesit (2007) ofron këtë përkufizim. Ato janë "vende fizike apo faqe të internetit të cilat ofrojnë përmes internetit 24 orë qasje në materiale të shkruara, video dhe zëra në formë digjitale". Ndërkaq, Magazina PC, një nga magazinat më të popullarizuar në fushën e kompjuterit, bënë këtë përkufizim për bibliotekat virtuale: "Koleksione librash, revistash dhe artikujsh nga e mbarë bota të cilat mund të qasen përmes internetit". Së këndejmi, të gjitha këto përkufizime dhe dallime të vogla nuk janë shumë të theksuara sa për të mos i përfshirë të gjitha këto nën konceptin e "bibliotekës digjitale'. Dallimet janë kryesisht në përqendrimin e fushëveprimit e jo aq shumë në substancë. Përderisa përkufizimi i Federatës së Bibliotekave Digjitale ishte gjithëpërfshirës duke u përqendruar në personelin, koleksionet, organizimin, përzgjedhjen, qasjen, audiencën, etj., përkufizimet e tjera e theksojnë më shumë në koleksione dhe qasje përmes internetit.

Meqë, kryesisht kemi të bëjmë lidhur me koleksionet digjitale, atëherë këto u mundësuan falë teknologjisë së kompjuterit. Disa dokumente tradicionale, me të cilat nënkuptojmë, dokumente në letër, si libra, revista, gazeta, etj., me të

skanuar e ndryshojnë krejtësisht natyrën e përpunimit me të cilat janë specializuar bibliotekat tradicionale. Duke ia shtuar kësaj edhe krijimin e dokumenteve tanimë drejtpërdrejtë në kompjuter si në 'Word' apo mënyra të tjera, si fotografi, zëra, muzikë elektronike, etj., dhe duke e zgjeruar konceptin e emërtimit "dokument" edhe për fotografi, incizime zanore, video, etj., në "burim" bëhet e pamundur mënyra tradicionale e përpunimit dhe e organizimit të tyre. Kështu që bibliotekat digjitale janë zgjidhja e duhur për t'u marrë me përpunimin, organizimin, ruajtjen dhe shërbimin e tyre për përdoruesit të cilët kërkojnë dokumente të tilla.

Pra, është teknologjia dhe natyra e re e dokumenteve e cila ka mundësuar, apo më mirë të themi, e ka detyruar njerëzimin në shpikjen dhe zhvillimin e bibliotekave digjitale. Përderisa një bibliotekë tradicionale është marrë me mbledhjen, përpunimin, organizimin dhe shërbimin e dokumenteve për përdorues, si dhe ruajtjen e tyre për brezat e ardhshëm, e njëjta gjë vlen edhe për bibliotekat digjitale. Mirëpo probleme paraqiten, sidomos, me bibliotekat digjitale, pasi zhvillimi i tyre është ende në fazën fillestare. Derisa në njërën anë, bibliotekat tradicionale ishin mësuar me një numër të kufizuar formatesh, si libër, periodik, fotografi, dorëshkrime, materiale arkivore, etj. në anën tjetër bibliotekat digjitale përballen me një sfidë shumë më të madhe të formateve të ndryshme, si '.doc', '.pdf', '.html', '.jpeg', '.gif', '.mpeg', '.mp3', e dhjetëra e dhjetëra formate të tjera, për të cilat duhet të gjendet zgjidhje për ruajtjen e tyre, aspekt shumë më rëndësi në zhvillimin dhe ekzistimin e bibliotekave.

Pra, shihet që zhvillimi dhe mbështetja e bibliotekave digjitale, e në këtë aspekt edhe i bibliotekave digjitale të muzikës, në veçanti, është i domosdoshëm për ruajtjen e trashëgimisë intelektuale e mendore të krijuar vetëm në formë elektronike, të ruhet për brezat e ardhshëm, si dhe për t'u shërbyer brezave të tanishëm. Më poshtë do të trajtojmë zhvillimin e bibliotekave digjitale të muzikës dhe burimet të cilat ofrojnë.

BIBLIOTEKAT DIGJITALE TË MUZIKËS

Pasi dhamë një shtjellim paksa të mjaftueshëm më lartë për bibliotekat digjitale, në përgjithësi, e kemi më të lehtë në përkufizimin e fushëveprimit të bibliotekat digjitale të muzikës. Pra ato janë biblioteka të specializuara të cilat ofrojnë incizime zanore, partitura, libra dhe revista elektronike të muzikës apo lidhur me muzikën, me një fjalë "burime elektronike" muzikore të formave të ndryshme. Ajo që i bënë ato edhe më të veçanta është dobia e tyre në raport me përdoruesit. Fjala është për mundësinë që përdoruesi t'i qaset burimit që e kërkon përmes internetit pa marrë parasysh se ku është krijuar burimi apo vendin ku gjendet vetë përdoruesi. Po ashtu, po qe se teknologjia e kompjuterit dhe e internetit do të jenë stabile, në aspektin e jetëgjatësisë pa marrë parasysh ndryshimet gjatë zhvillimit të tyre, mund të sigurojë qasje dhe ruajtje të këtyre burimeve për breza të tërë në të ardhmen.

Në vijim kemi marrë si shembuj disa biblioteka digjitale të muzikës për ta ilustruar në kontekst atë se çfarë janë dhe çfarë shërbimesh ofrojnë. Njëra prej tyre është projekti i koleksioneve digjitale të partiturave në Bibliotekën e Muzikës së Universitetit të Harvardit. Ky projekt përfshinë digjitalizimin e dhjetëra veprave muzikore në partitura të kompozitorëve më me renome botërore, si partiturat e: Johann Sebastian Bach - ndër to: Die Katechismus-Gesänge. etj; të Wolfgang Amadeus Mozart - ndër to: Il flauto magico : dramma per musica = Die Zauberfloete: grosse Oper in zwey Ackten dal Signor W.A. Mozart (botimin e parë), Die Entführung aus dem Serail del Sigr. Mozart (partiturë e fundit të shekullit të 18), etj.; të Giuseppe Verdi -

Figura 1. Partiturë e digjitalizuar e W. A. Mozart



ndër to: Don Carlos: grand opéra en cinq actes / Poème de M.M. Méry et C. du Locle; musique de G. Verdi; partition in 8o, piano et chant[1867?], Macbeth: dramma lirico in quattro atti. [1851], etj. Shembulli i mëposhtëm ofron një faqe të shfletuar të njërës prej partiturave të Mozart-it.

Partiturat e këtyre kompozitorëve ofrohen falas përmes internetit për të gjithë të interesuarit nga e mbarë bota dhe paraqesin një mundësi për studiuesit në këtë fushë që të qasen përmes internetit në materiale unikate.

Një projekt tjetër është edhe Choral Public Domain Library, e paraqitur në Figurën 2, e cila ofron muzikë falas në formate të ndryshme, si partitura dhe incizime zanore. Kjo bibliotekë digjitale e muzikës është e pasur me informacione të kompozitorëve të ndryshëm botëror dhe veprave të tyre. Deri në prill të vitit 2010, faqja e kësaj biblioteke digjitale ofron mbi 11,385 faqe në partitura muzikore, mbi 1,614 faqe për kompozitorë, mbi 1770 përkthime, etj.

Botuesit e muzikës të cilët mundësojnë qasje me abonim me pagesë ofrojnë një numër të madh të burimeve elektronike të muzikës të formave të ndryshme. Një prej tyre është Grove Music, e ofruar përmes veprimtarisë botuese të Universitetit të Oxfordit (Oxford University Press). Grove Music është burim në internet, i cili përfshinë: The New Grove Dictionary of Music and Musicians, The New Grove Dictionary of Opera dhe The New Grove Dictionary of Jazz. Si i tillë, Grove Music është njëri prej burimeve referale më autoritative në fushën e muzikës. Ky burim ofron mbi 45,000 artikuj për njerëz, vende, instrumente dhe teknika, zhanre dhe stile; mbi 5000 lidhje në imazhe, incizime zanore dhe faqe të tjera; mbi 500 shembuj zanor të muzikës; mbi 20, 000 biografik nga Mozarti deri te Yo-Yo Ma, Dighilev, pastaj P.T. Barnum, Fats Waller e Thin Man, etj. (Grove Music, 2006). Duhet të theksohet se ky burim tash ofrohet përmes internetit dhe shërbimeve të Bibliotekave Muzikore të Bibliotekës Kombëtare dhe Universitare të Kosovës, si pjesë e sponsorizimit të Raiffeisen Bank të bërë kohë më parë. Për t'i shfrytëzuar këto burime, përdoruesit dhe të interesuarit duhet t'i drejtohen personelit të kësaj biblioteke të specializuar. Figura 3 më poshtë ilustron faqen hyrëse të Grove Music, e cila në këtë faqe ofron mënyra të ndryshme të kërkimit, si kërkim të avancuar, të dëgjuarit e pjesëve muzikore, shfletimin dhe hulumtimin e burimeve që gjenden në të. Po ashtu nga kjo faqe shohim, nën kategorinë për kërkim të avancuar, edhe llojet e materialeve apo informacioneve të cilat mund t'i gjejmë, e që përfshijnë: artikuj me tekst të plotë, biografi, bibliografi, lidhje në burime të ndryshme, vepra të muzikantëve të ndryshëm, etj.

Figure 2. Choral Public Domain Library.

Figure 3. Faqja e internetit të Grove Music.

Në Figurën 4, kemi ilustruar një kërkim në Grove Music. Kërkimi është bërë për Ludwig Van Beethoven, me opsionin kërkim i avancuar. Nga kjo figurë shohim, në anën e majtë të faqes, llojet e ndryshme të informa-

Figure 4. Kërkim i avancuar për Ludwig Van Beethoven



cioneve për muzikantin, në këtë rast Ludwig Van Beethoven, ndërsa në faqen në mes shfaqen informacione të radhitura në anën e majtë me rastin kur klikojmë në to. Shembulli, po ashtu, paraqet edhe informacionet e pasura, të hollësishme, autoritative dhe të llojllojshme, të cilat mund të gjenden në këtë burim.

EBSCOhost, një botues tjetër komercial, përmes produktit të saj Academic Search Premier, në të cilën Biblioteka Kombëtare dhe Universitare abonon gati që prej pasluftës së fundit, ofron afro 85 revista shkencore të fushës së muzikës ose që kanë të bëjnë me të, si: Music Analysis, Music Review, 19th Century Music, Contemporary Music Review, Crosscurrents — Journal of Ancient Music, Pre-history, Archaeology & Origins (& Other Social History & Science Matters), Popular Music & Society, Popular Music History, Ethnomusicology Forum, Rolling Stone, Electronic Musician, Journal of Musicological Research, Bach Perspectives (University of Nebraska Press), etj. Këta tituj nuk paraqesin ndonjë preferencë nga ana e jonë, por shërbejnë vetëm si ilustrim të titujve që përdoruesit mund t'i gjejnë në këtë bazë të dhënash përmes Bibliotekës Kombëtare dhe Universitare.

Në rrafshin e muzikës shqipe janë krijuar disa faqe të internetit të cilat mbledhin apo ofrojnë qasje në muzikën e hershme dhe të kohës së fundit, kryesisht në audio, por nganjëherë edhe shënime për muzikantët. Duke mos gjykuar në aspektin e të drejtës autoriale, pjesa më e madhe e faqeve të muzikës në shqip përmes internetit paraqesin shembuj për krijimin e mundësive të qasjes për përdoruesit të interesuar në muzikën shqipe. Një fakt me rëndësi është që një pjesë e madhe e këtyre faqeve të internetit me informacione muzikore në shqip janë veprimtari dhe investime të individëve, e jo të institucioneve publike apo private të specializuara, të cilat merren me mbledhjen, organizimin dhe ruajtjen e trashëgimisë intelektuale të Kosovës apo me gjerë, si bibliotekat, arkivat, apo institucionet e tjera arsimore e kulturore. Biblioteka Kombëtare dhe Universitare e Kosovës, përveç se ka filluar të krijojë të dhëna bibliografike në katalogun elektronik të materialeve që i posedon, nuk ka bërë ndonjë hap tjetër në digjitalizimin e materialeve të saj apo në krijimin e ndonjë faqe zyrtare për materialet muzikore.

Natyrisht se mbledhja apo ofrimi i muzikës përmes internetit në formë ilegale dhe forma të tjera të ndryshme nga individë sipas dëshirës së tyre apo për qëllime komerciale ka vënë në pikëpyetje veprimtarinë e disa produksioneve muzikore në Kosovë, siç është rasti i prononcimit të produksionit muzikor Labia në gazetën "Koha Ditore" të datës 23 tetor 2007, ku thuhet se "'Labia' do të presë deri në fund të këtij viti për të parë nëse do ta vazhdojë punën. "Zico Company" është dorëzuar dhe nuk planifikon më që të hyjë në treg në këto rrethana". Nga këto prononcime, duket se njëri prej shkaktarëve të rrezikimit të aktivitetit të këtyre produksioneve muzikore është pirateria nëpër rrugët e qoshqet e Kosovës, të cilët i manipulojnë incizimet e tyre; ndërsa tjetri mund të jetë pirateria përmes internetit, ku muzika për të cilën e mban të drejtën autoriale ky produksion, mund të qaset falas përmes disa faqeve të internetit qoftë të krijuara në Kosovë apo edhe jashtë saj. Ky fenomen është mjaft i përhapur në Kosovë edhe pse ligjërisht është i ndaluar përmes Ligjit për të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të përafërta, i miratuar nga Kuvendi i Kosovës në qershor të vitit 2006.

Në përfundim të këtij trajtimi mund të themi se bibliotekat digjitale të muzikës paraqesin zhvillimin më të ri të bibliotekave muzikore. Me ndihmën e internetit dhe të teknologjisë së kompjuterit në përgjithësi, po bëjnë të mundur qasjen në burime elektronike dhe atyre tradicionale përmes projekteve të digjitalizimit për përdorues e studiues nga e mbarë bota, duke e bërë muzikën edhe më universale, edhe më të përhapur, edhe më të pranishme në kulturat e pasura botërore. Para se të përfundojmë, mund të konstatojmë se Biblioteka Muzikore e Bibliotekës Kombëtare dhe Universitare të Kosovës duhet të pajiset edhe me teknologjinë e digjitalizimit për ta digjitalizuar, ofruar në formë elektronike dhe ruajtur trashëgiminë e pasur muzikore të Kosovës dhe më gjerë.

Bibliotekat digjitale të muzikës nuk mund të merren me dokumente tradicionale pa intervenuar në to, vetëm nëse ato skanohen apo bëhen në një mënyrë apo tjetër të kuptueshme për kompjuterin. Në anën tjetër, bibliotekat tradicionale nuk mund të merren me dokumente digjitale, pasi natyra e tyre ndryshon prej letrës [partiturave]. Bibliotekat tradicionale mund të zhvillojnë shkathtësi dhe të bëhen vend ku zhvillohet aktiviteti i bibliotekave digjitale, në përgjithësi, dhe atyre të muzikës, në veçanti, pasi ato nuk mund të ekzistojnë vetëm virtualisht. Prandaj, sot është me rëndësi që të dy këto realitete bibliotekare - tradicionale dhe digjitale - të kihen parasysh dhe të trajtohen njëlloj pasi industria e botimeve vazhdon paralelisht në të dy drejtimet, si të botimeve tradicionale në letër, po ashtu edhe të atyre të botuar drejtpërdrejt në internet, e të cilat mund të mos gjenden fare në letër.

BIBLIOTEKA E UNIVERSITETIT AMERIKAN NË KOSOVË

HAZBIJE QERIQI

(Bibliotekare në Bibliotekën e Universitetit Amerikan në Kosovë)

HYRJE

Biblioteka e Universitetit Amerikan në Kosovë është themeluar në shkurt të vitit 2007, pas ndihmës 50,000 eurosh të ish-Zyrës Amerikane në Prishtinë (tani Ambasadë e SHBA-ve në Prishtinë). Fillimisht, ishte një bibliotekë e vogël, por e projektuar me një hapësirë unike, duke u mundësuar studentëve vend të qetë studimi: një sallë leximi, një dhomë studimi për punë në grupe, dhe një hapësirë për periodikun ditor. Me këtë grant të dhuruar, u blenë libra, kryesisht tekste shkollore, materiale referale, burime elektronike, video e DVD të ndryshme. Pastaj, revista e gazeta ditore. Më pas, në pranverë të vitit 2009, kjo bibliotekë u zgjerua edhe në dy kate të tjera. Edhe kësaj radhe rikonstruksioni u bë me ndihmën e Ambasadës Amerikane në Prishtinë, ndërsa biblioteka u emërua - Biblioteka Përkujtimore "Irwin Metzger". Me këtë grant u hap edhe Qendra për Media, e cila ka pajisje për produksion multimedial që ofron shërbime shtesë, si: dizajn grafik, ueb-dizajn, fotografi/imazhe, video-editim dhe audio-incizime, ku studentët tanë kanë mundësi t'i kryejnë detyrat e tyre, në përputhje me planin dhe programin mësimor në drejtimin Media dhe Komunikim Grafik.

Universiteti Amerikan në Kosovë është në partneritet të ngushtë me Institutin e Teknologjisë në Rochester

Qendra për Media

(RIT), i cili është një nga universitetet më të mëdha në SHBA. Si pjesë e këtij partneriteti, biblioteka ka një mbështetje të fuqishme nga biblioteka e RIT-së http://library.rit.edu/ kryesisht në burime elektronike, në huazim ndërbibliotekar, por edhe në këshillime e prezantime të ndryshme.

Më 12 janar 2009 biblioteka e AUK-ut ka nënshkruar një marrëveshje me Bankën Botërore për hapjen e Depoziturës së Bankës Botërore në ambientet e bibliotekës sonë, si dhe materiale nga burimet online: WDI ONLINE, GDF ONLINE, WORLD BANK E-LIBRARY, and GLOBAL MONITORING REPORT. Pas kësaj ndihme, ne mund të ofrojmë shërbime publike jashtë AUK-ut.

Që nga 26 janari i vitit 2009, biblioteka e AUK-ut është anëtare e Konsorciumit Ndërkombëtar të Modelit Amerikan për Biblioteka Universitare (AMICAL), i themeluar më 2004 dhe i mbështetur nga Andrew W. Mellon Foundation. Ky konsorcium në vete ka 22 institucione të edukimit të lartë jashtë SHBA-ve, kryesisht të 18 shteteve të

Biblioteka e Universitetit Amerikan në Kosovë

Evropës Qendrore dhe Perëndimore, të Afrikës Perëndimore dhe Veriore, të Lindjes së Mesme, të Azisë Qendrore dhe Rusisë.

Po ashtu, këta muaj biblioteka e AUK-ut ka qasje edhe në databazat etnografike/arkeologjike të Dokumenteve në Fushën e Marrëdhënieve Njerëzore të Universitetit të Yale-it në SHBA (The Human Relation Area File, HRAF).

Së fundmi, më 4 janar të vitit 2010, biblioteka e Universitetit Amerikan në Kosovë u bë anëtari më i ri i "Kohës", që është një Sistem i Integruar Bibliotekar. Tani, jemi në zbatimin e këtij sistemi.

Ueb-faqja e Bibliotekës së AUK-ut

ORGANIZIMI I BIBLIOTEKËS

Biblioteka e AUK-ut aplikon rregullat anglo-amerikane të katalogimit (AACR2) për përshkrimin bibliografik të njësive bibliotekare. Përdor Klasifikimin e Djuit (Dewey Decimal Classification System), dhe numrin e Cutter-it. Kurse, për Përcaktues lëndor (Subject Headings) përdor atë të Bibliotekës së Kongresit Amerikan.

Në mënyrë që të jetë më e lehtë për përdoruesit e bibliotekës gjetja e materialeve të kërkuara, renditja e librave në rafte është bërë sipas Klasifikimit të Djuit, duke vendosur në raft edhe Përcaktuesin lëndor karshi librit.

Biblioteka, koleksionet e veta i ka të ndara në: koleksionin e përgjithshëm, koleksionin e materialeve të veçanta apo referale; koleksionin e lëndëve mësimore, koleksionin e materialeve në rezervim (materiale këto, që vetë profesorët kërkojnë të rezervohen për kohë të caktuar, dhe të cilat kryesisht nuk lejohen të dalin jashtë bibliotekës), koleksionin për Kosovën, koleksionin e serialeve, videove, DVD-ve dhe incizimeve të ndryshme, dhe së fundmi, tashmë është duke u punuar në krijimin e koleksionit të Historisë së Evropës Juglindore, si dhe në krijimin koleksionit të materialeve online të temave të magjistraturës.

Prioriteti kryesor për administratën e AUK-ut për vitin 2010-2011 është ta zgjerojë koleksionin e bibliotekës, posaçërisht në fushën e historisë dhe atë të politikës publike.

Po ashtu, në ueb-faqen e bibliotekës së AUK-ut kemi disa databaza me libra elektronikë, materiale në PDF, etj.

Pasurimi i bibliotekës me tituj të rinj, të nevojshëm për studentët dhe stafin akademik të universitetit, bëhet në disa forma. Çdo vit, universiteti ndan një buxhet të caktuar për blerje. Mirëpo, pjesa më e madhe vijnë nga donatorët, të cilët kryesisht janë profesorët nga RIT-ja, apo dhurues të tjerë. Në këtë kontekst, biblioteka pasurohet edhe nga donacione që vijnë nga vetë botuesit apo edhe autorët tekstesh fushash të ndryshme, të cilët dëshirojnë që librat e tyre të jenë pjesë e bibliotekës së universitetit tonë. Ndër autorë të rëndësishëm, është shkrimtari Ismail Kadare, i cili i dhuroi bibliotekës sonë kompletin e librave të tij. Ai vitin e kaluar, u shpall "Doktor Nderi i Letërsisë" nga Universiteti Amerikan në Kosovë. Ndër autorë të njohur është edhe shkrimtari e albanologu i njohur - Robert Elsie, si dhe shumë autorë të tjerë nga fusha akademike dhe kulturore.

Bashkëpunimi i bibliotekës së AUK-ut me atë të RIT-së

Si pjesë e një partneriteti të ngushtë me Institutin e Teknologjisë në Rochester në SHBA (RIT), biblioteka e AUK-ut ka një mbështetje të jashtëzakonshme nga biblioteka e RIT-së. Çdo fillimviti akademik, nga biblioteka e RIT-së organizohen prezantime për studentët e AUK-ut. Studentët, profesorët dhe stafi i AUK-ut mund të bëjnë hulumtime në mbi 250 baza të dhënash elektronike të bibliotekës së RIT-së, të cilat përmbajnë libra në formë elektronike, publikime të ndryshme, si dhe një numër jashtëzakonisht të madh të artikujve shkencorë, po ashtu në formë elektronike.

Biblioteka e AUK-ut ka një bashkëpunim të mirëfilltë në huazimin ndërbibliotekar me bibliotekën e RIT-së. Profesorët e AUK-ut, për ta zhvilluar profesionin e mësimdhënies, kanë mundësi ta përdorin koleksionin e rezervuar të bibliotekës së RIT-së për çfarëdo literature të nevojshme që iu duhet, ndërsa që këshillimet profesionale nga biblioteka e RIT-së janë pjesë e punës së përditshme.

Biblioteka e AUK-ut dhe ajo e RIT-së janë gjithmonë në dispozicion për të ofruar ndihmë në punën e referencave, si dhe në hulumtim.

HISTORIKU DHE PERSPEKTIVAT E ZHVILLIMIT TË BIBLIOTEKAVE NË KOSOVË

SAHADETE SADIKAJ - KUKAJ

(Drejtoreshë e Bibliotekës Ndërkomunale të Prizrenit)



Biblioteka e Suzi Çelebiut në Prizren (1513)

Që ta njohim më mirë kuptimin e fjalës bibliotekë duhet të dimë edhe vendin e saj në shoqëri, hapat e zhvillimit dhe transformimit të saj. Biblioteka me shekuj ka pasur funksion të ruajtjes dhe kultivimit të lidhjes në mes të kaluarës dhe së ardhmes, historisë dhe shoqërisë.

Duke e parë traditën e bibliotekave në botë dhe në Evropë, koha e shfaqjes së bibliotekave në Kosovë është më e vonë, edhe pse ekziston një traditë që është me rëndësi të hulumtohet.

Ekzistimi i bibliotekave, të cilat kanë funksionuar në territorin e Kosovës lidhet me kohën mes shekujve XIV-XV, me faktin e njohur për ekzistimin e bibliotekës në Prizren - bibliotekës se Suzi Qelebiut (1513). Pas kësaj kohe, vijmë deri në shek. XIX-XX, për të folur prapë për ekzistimin e bibliotekave - pra ekziston një boshllëk i madh mes shekujsh, ku nuk gjejmë dot dokumente për ekzistimin e bibliotekave në Kosovë. Në shek. XIX flitet për ekzistimin e bibliotekave në Prishtinë, Pejë, Gjakovë, Mitrovicë, Gjilan, Vushtrri, porse nuk ka materiale e dokumente të mjaftueshme për të treguar qartë vendin e ekzistimit të tyre, fondin dhe mënyrën e funksionimit të tyre.

Si shembull për bibliotekën e parë publike paraqitet viti 1227 (sipas Hixhrit) - më 1812, me kalendarin kristian, me bibliotekën e njohur të Mahmud Pashës, e cila mendohet se paraqet fillimet bibliotekës së parë publike në Kosovë, për të vijuar pastaj me bibliotekat e tjera në qytete të ndryshme të Kosovës.

Pas Luftës së Dytë Botërore, viti 1944 konsiderohet si data e themelimit të bibliotekës publike të Prizrenit, që përkon me kohën e themelimit edhe të shumë institucioneve të tjera në Prizren (pasi që në atë kohë Prizreni ishte qendër e rëndësishme e Kosovës).

Nga Prizreni, pas dy vitesh, biblioteka do të kalojë në Prishtinë. Pas kësaj kohe nis themelimi i bibliotekave publike edhe nëpër qytetet e tjera të Kosovës, si në Gjilan, Pejë, Prishtinë, Mitrovicë etj.

Ndërsa që periudha më e rëndë për bibliotekat e Kosovës është periudha e kohës së shpërbërjes së ish-Jugosllavisë dhe në veçanti gjatë luftës dhe pushtimit serb të Kosovës. Kur u dogjën biblioteka deri në themel, dhe u shkatërruan shumë fonde të librave, të cilat gjatë një periudhe 50-vjeçare ishin pasuruar.

Ndërtimi, meremetimi dhe pajisja e bibliotekave do të nisë me një dinamikë të fuqishme pas luftës, ku provohet të rimëkëmbet kapaciteti i bibliotekave, për të përmbushur nevojat fillimisht emergjente, të përdoruesve në Kosovë. Për të ditur më shumë për numrin e bibliotekave në Kosovë, mund t'u referohemi raporteve të Bibliotekës Kombëtare dhe Universitare të Kosovës, si dhe Entit Statistikor të Kosovës, ku paraqiten bibliotekat publike, shkollore, si dhe bibliotekat speciale dhe shkencore.

Me qëllim të mbarëvajtjes së punës në bibliotekat e Kosovës, rëndësi të veçantë tashmë ka krijimi i rrjetit bibliotekar. Arsyet e krijimit te rrjetit bibliotekar janë: përmirësimi i shërbimeve ekzistuese, ofrimi i shërbimeve të reja, ofrimi i më shumë informacioneve, ardhja më e shpejtë

në informacion, ndërrimi i shërbimeve të vjetra dhe të shfrytëzuara, përmirësimi i teknologjisë, mbizotërimi më i lehtë i punëve, zvogëlimi i shërbimeve operative, shtimi i disponimit të personelit , shtimi i kënaqësisë së shfrytëzuesve, përforcimi i mbikëqyrjes, etj.

Tashmë në Kosovë funksionojnë biblioteka të tipave të ndryshëm, si: Biblioteka Kombëtare dhe Universitare e Kosovës, Bibliotekat Ndërkomunale, Bibliotekat Komunale, Bibliotekat e fshatrave, Bibliotekat speciale dhe të veçanta, Bibliotekat fetare, Bibliotekat shkollore, Bibliotekat Private, Bibliotekat lëvizëse etj. Të mëdha apo të vogla, kombëtare apo vendore, universitare apo shkollore, shkencore a fetare, publike a private, bibliotekat tona, me rrjetin kombëtare që do të formonin, do të ndihmonin për ndërtimin e një katalogu unik për gjithë Kosovën, që tashmë është nismë e Bibliotekës Kombëtare dhe Universitare të Kosovës dhe po përkrahet edhe nga Bibliotekat Ndërkomunale të Kosovës.

Duke i parë këto nisma të mira për zhvillimin e bibliotekave, do të duhej t'i përkrahnin edhe institucionet qeveritare të Kosovës, për t'i tejkaluar vështirësitë që paraqiten në fusha të ndryshme, si: shtrirja e rrjetit bibliotekar, bashkëpunimi i bibliotekave në mes veti, zhvillimi i fondit bibliotekar, kualifikimi i kuadrit bibliotekar, hapësira e pamjaftueshme e bibliotekave dhe e kushteve të punës, paqartësia e sistemit financiar të bibliotekave etj.

Detyrat e bibliotekave, si shërbime shoqërore, tregojnë se tashmë është e domosdoshme të ndërrohet koncepti për rolin e bibliotekave në kulturë, histori, arsim, informim, edukim. Shërbimet e bibliotekës duhet të shtrihen jo vetëm te përdoruesit që kanë mundësi të vijnë vetë në bibliotekë, por edhe te kategoritë e tjera të njerëzve me nevoja të veçanta, te të cilët janë të nevojshme shërbimet bibliotekare.

Është e rëndësishme që, për zhvillimin e bibliotekave në Kosovë, të investohet në përgatitjen dhe aftësimin e stafit bibliotekar në përputhje me trendet bashkëkohore të bibliotekarisë, fillimisht nëpërmjet seminareve, trajnimeve, sesioneve për probleme të veçanta etj.

Në këtë kontekst, synimi i bibliotekës drejt avancimit dhe bërjes së saj qendër e informacionit, do të duhej të orientohej kryesisht në: krijimin e ambientit të përshtatshëm, kultivimi te lexuesit i ndjenjës për kulturën e librin, pajisjen e bibliotekës më teknologjinë më të re për bibliotekat, rritjen e kualitetit të shërbimeve ndaj lexuesve, pasurimi i fondeve bibliotekare nëpërmjet politikave të qarta të zhvillimit të koleksioneve, angazhimi për sigurimin dhe arkivimin e materialit bibliotekar, zgjerimin e bashkëpunimit mes bibliotekave, zgjerimi i formave të aktiviteteve me lexues, përpunimi i materialit bibliotekar në përputhje me standardet bibliotekare etj.

Pra, do të duhet një vullnet i madh i komunitetit bibliotekar dhe një përkrahje e vazhdueshme e institucioneve relevante financiare, të cilat mbikëqyrin punën e bibliotekave, në mënyrë që të gjenden rrugët adekuate për realizimin e projekteve, të cilat shpejt do ta fusnin në binarët normal trendin e zhvillimit e të konsolidimit të bibliotekave në Kosovë, në përputhje me zhvillimet dhe kërkimet aktuale të informacionit dhe të nevojës së përdoruesve për të tilla shërbime nga biblioteka.

SFIDAT E BIBLIOTEKAVE (NDËR)KOMUNALE

(KALIMI I BIBLIOTEKAVE NDËRKOMUNALE NËN MENAXHIMIN E KOMUNAVE)

SHKURTË KADRIU – ÇITAKU

(Udhëheqëse e Divizionit të Promovimit në Departamentin e Kulturës, në Ministrinë e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve)

Bibliotekat Ndërkomunale kanë sfida të mëdha ligjore, profesionale e buxhetore me te cilat ju mbetet të përballen këtë vit.

Me delegimin e kompetencave të Bibliotekave Ndërkomunale në nivel komunal, Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve (MKRS), ka hequr barrën në vijën e menaxhimit financiar në Sektorin e Bibliotekave, mirëpo jo edhe në atë profesional. Sa e ndien vetën MKRS të obliguar të mbështes Bibliotekat Ndërkomunale (tash Komunale) në aspektin profesional dhe në atë të subvencionimit mund të qartësohet më lehtë në Marrëveshjen e Mirëkuptimit të nënshkruar muaj më parë ndërmjet tri ministrive rreth kësaj çështjeje: Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Ministrisë së Administratës dhe Pushtetit Lokal, Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave dhe komunave përkatëse.

Marrëveshja e Mirëkuptimit për kalimin e Bibliotekave Ndërkomunale në Biblioteka Komunale ka filluar të zbatohet në fillimvitin e sivjetmë. Bazuar në këtë marrëveshje sa i përket shërbimeve bibliotekare, MKRS është përgjegjëse për hartimin e infrastrukturës juridike që rregullon ofrimin e shërbimeve bibliotekare dhe mbikëqyrë zbatimin e legjislacionit në fuqi, është përgjegjëse për hartimin e politikave dhe përgatitjen e planeve strategjike për zhvillim të shërbimeve bibliotekare. Ajo do t'i hartojë edhe standardet për ofrimin e shërbimeve bibliotekare si dhe për monitorimin dhe inspektimin e këtyre shërbimeve. Madje në rrethana të veçanta kur komuna ose ndonjë subjekt tjetër që ofron shërbime bibliotekare nuk i plotëson në mënyrë të vazhdueshme standardet minimale të specifikuara nga MKRS, MRKS mund të marrë përsipër drejtpërdrejt mbështetjen e kryerjes së shërbimeve të tilla për aq kohë sa është e nevojshme që situata të përmirësohet. MKRS gjithashtu do të jetë përgjegjëse të shqyrtojë edhe raportet vjetore të njësive gjegjëse komunale. Ndërsa në nivelin e shërbimeve shtesë bibliotekare ajo do të nxitë dhe mbështetë aktivitetet e bibliotekave publike për nevojat e diasporës, nevojat e vendeve rurale (me bibliobus), nevojat e minoriteteve etj. Një përgjegjësi të madhe në bazë të marrëveshjes ajo do ta ketë edhe për themelimin e bibliotekave të reja, prandaj do ta bartë një barrë të madhe në mbështetjen e komunave për themelimin dhe zhvillimin e bibliotekave komunale.

Pjesët e tjera të marrëveshjes në fjalë, Ministria e Administratës së Pushtetit Lokal dhe Ministria e Ekonomisë dhe Financave, kanë obligime të tjera të përcaktuara në bazë të kësaj Marrëveshje të Mirëkuptimit. Kurse, sa i përket komunave nikoqire të Bibliotekave Ndërkomunale ato do ta marrin përgjegjësinë për menaxhimin e stafit profesional të bibliotekave ndërkomunale sipas standardeve të caktuara nga MKRS-ja, do të menaxhojnë me ndërtesën ekzistuese të bibliotekave, me pajisjet dhe materialet e transferuara nga MKRS-ja. Gjithashtu do të përgatitet një plan përvijues i cili jep sqarime konkrete se si ofrohen shërbimet bibliotekare, në përputhshmëri me standardet minimale të caktuara nga MKRS-ja. Ato këtë plan në njërën anë do t'ia dorëzojnë MKRS-së për informim e në anën tjetër duhet ta caktojnë personelin e duhur për implementimin e tij nëpër bibliotekat e tyre përkatëse.

Bibliotekave Ndërkomunale iu mbetet edhe më tutje t'i mundësojnë MKRS- së inspektimin e të dhënave për t'i mbështetur raportet e tyre sipas nevojave. Po ashtu, ato duhet të respektojnë rregulloret, udhëzimet e procedura të tjera të përcaktuara nga MKRS-ja. Përgjegjësi tjetër e Bibliotekave Ndërkomunale është edhe raportimi vjetor me shkrim për shërbimet e tyre bibliotekare, ofrimi i shërbime adekuate profesionale, për të gjithë qytetarët pa dallim dhe sipas mundësive buxhetore të planifikohen mjete shtesë buxhetore nga të hyrat vetanake për zhvillimin dhe avancimin e shërbimeve bibliotekare. Ministria e Kulturës me qëllim të përmirësimit të cilësisë së shërbimeve bibliotekare, do të vazhdojë që Bibliotekave Ndërkomunale t'u ofrojë aktivitete të trajnimeve dhe zhvillimeve profesionale. Kjo pak a shumë



do të jetë korniza e bashkëpunimit në të ardhmen ndërmjet Bibliotekave Ndërkomunale, Komunave dhe Ministrive përgjegjëse në atë marrëveshje, obligimet dhe detyrat që do të kenë ndaj njëra tjetrës.

MENAXHIMI I NDRYSHIMEVE

Një ndër sfidat e kalimit të Bibliotekave Ndërkomunale në Biblioteka Komunale, si institucione kulturore që pasurojnë e ruajnë koleksionet në të gjitha fushat e krijimtarisë është ndërlidhja ligjore e tyre me Komunat përkatëse, pasurimi i koleksioneve, inventarizimi, trajnimet e kuadrit bibliotekar në aspektin profesional, funksionimi i E-Bibliotekave, prezantimi i projekteve me vlerë për subvencionim, zhvillimi i tyre në hap me bibliotekat e tjera rajonale e më gjerë, krijimi i plan-programeve dhe zbatueshmëria e tyre me profesionalizëm etj.

Autoritetin e deritanishëm të MKRS-së, në disa nene të Ligjit për Biblioteka e zëvendësojnë Komunat, prandaj evidentimi dhe respektimi i përgjegjësive reciproke të Komunave dhe Bibliotekave Ndërkomunale është elementar për të mundësuar funksionimin e mirë të shërbimeve bibliotekare. Normalisht se këto bartje kompetencash mund të lënë vakume të mëdha, prandaj tejkalimi i këtij problemi në formën më të mirë është një sfidë e madhe për të dy institucionet. Nevojë kjo që duhet të ngutet si kërkesë e domosdoshme meqë, çdo vonesë mund të ketë pasojat e veta që do të reflektonte vrazhdë në imazhin e këtyre Bibliotekave.

Bibliotekat Ndërkomunale nuk përcjellin ritmin e botimeve në Kosovë, si një kërkesë bazë e këtyre institucioneve, ato kanë ngecur prapa me koleksione në të gjitha fushat kulturore. Pasurimi me koleksione të reja dhe me ato të mëhershme është një sfidë e madhe e ardhme e Bibliotekave Ndërkomunale. Në anën tjetër problemi i revizionit të fondeve të bibliotekave është problem që edhe sot e kësaj dite nuk është përfunduar mirë, prandaj tejkalimi i tij dhe pasurimi i fondit bibliotekar mbi bazë të rezultateve të vjetra është kryesor për të mos përsëritur blerjen e koleksioneve të njëjta nga disa herë.

Inventari i Bibliotekave Ndërkomunale është kryesisht i viteve '80, '90 ose edhe i mëhershëm, dhe në një gjendje shumë të rëndë. Gjendje kjo e konstatuar edhe nga Komisioni i përcaktuar në kuadër të Këshillit Kombëtar të Bibliotekave të Kosovës, që funksionon në kuadër të MKRS-së. Deri tash pothuajse përgjithësisht nuk ka ndonjë veprim konkret nga Komunat që do të ndikonte në përmirësimin pozitiv të gjendjes së këtyre bibliotekave. Inventari i vjetër përveç të tjerash ndikon në zbehjen e shërbimeve profesionale bibliotekare, në ngadalësimin e shërbimit të librit, të përpunimit të tij, shërbimit në sallat e leximit etj., duke krijuar hapësirë për ngecje të kësaj pjese të ndjeshme e të rëndësishme të këtij Sektori.

Trajnimi i kuadrit bibliotekar në aspektin profesional dhe funksionimi i E-Bibliotekave është domosdoshmëri po qe se shohim trendet botërore dhe koncentrimin e tyre të madh në digjitalizimin e bibliotekës: në të dhënat bibliotekare, shërbimeve elektronike, komunikimit nga largësia etj. Në këtë aspekt Bibliotekat e Kosovës kanë çaluar në E-biblioteka, duke krijuar një hendek të madh në relacion me bibliotekat rajonale e më gjerë. Kjo ide mund të argumentohet me faktin se në asnjë bibliotekë të Kosovës nuk mund të gjendet një katalog që do të ishte gjithëpërfshirës në prezantimin e të gjithë titujve të asaj biblioteke.

Në këtë sferë për Bibliotekat Ndërkomunale mbetet sfidë edhe profesionalizimi i stafit me shërbimet elektronike, krijimi i katalogëve, mundësia e porosisë së librit nga largësia etj. Këto veprime duhet të kryhen intenzivisht në qoftë se Bibliotekat Ndërkomunale dëshirojnë të renditën në vijën e Bibliotekave moderne rajonale. Komunikimi më i madh i Bibliotekave Ndërkomunale me bibliotekat simotra dhe bibliotekat jashtë vendit do të avanconte bibliotekarin e Kosovës në këtë drejtim, duke parë modelet e ndryshme të funksionimit të E-bibliotekave.

NDRYSHIMI DHE PËRSHTATSHMËRIA E LIGJIT TË BIBLIOTEKAVE

Rëndësi e veçantë në fushën e legjislacionit me kalimin apo transformimin e Bibliotekave Ndërkomunale në Biblioteka Komunale është ndryshimi i Ligjit të Bibliotekave me qëllim që të ketë përshtatshmëri dhe bartje të kompetencave adekuate nga MKRS në Komuna. Prandaj Ligj i bibliotekave patjetër se duhet të rishikohet dhe të ndryshohet nga ekspertë të lëmit përkatës, të cilët duhet të zgjidhen nga Këshilli Kombëtar i Bibliotekave në bashkëpunim me organet më të larta gjegjëse. Ligji i deritanishëm i Bibliotekave ka poseduar mangësi serioze, kështu që zgjedhja e një komisioni adekuat dhe profesional do t'i mënjanonte gabimet dhe mangësitë e paraqitura në ligjin e deritanishëm. Për këtë çështje Divizoni i Promovimit i ka propozuar Zyrës Ligjore të paraqesë ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit të Bibliotekave në nene të caktuara. Prandaj, puna në vijim e MKRS - së duhet të jetë ndryshimi, plotësimi dhe procedimi i Ligjit në Kuvendin e Kosovës.



SUBVENCIONIMI NGA MKRS

Përkundër bartjes së Bibliotekave nga kompetencat menaxhuese qendrore në ato lokale, Ministria e Kulturës Rinisë dhe Sportit, gjegjësisht Departamenti i Kulturës, në kuadër të konkursit të shpallur të Divizionit të Promovimit edhe këtë vit ka subvencionuar projekte të ndryshme të Bibliotekave Ndërkomunale. Përpjekje kjo e MKRS-sës që të përkrah edhe më tutje zhvillimin e mëtutjeshëm të këtyre bibliotekave.

Për fund mund të themi se Bibliotekat Ndërkomunale kanë sfida të mëdha si ligjore, ashtu edhe profesionale e buxhetore me të cilat iu mbetet të përballen këtë vit.

Ndërkomunikimi i mirë me komunat nga të cilat do të menaxhohen, do të hapë shtigje për tejkalimin e tyre. Në këtë rrugë të transformimit të Bibliotekave Ndërkomunale, edhe Ministritë e angazhuara me Marrëveshjen e Mirëkuptimit, do të jenë të obliguara t'i mbështesin ato, secila në fushën e vet.

PËR LIGJIN NË MBROJTJE TË KOLEKSIONEVE TË VEÇANTA

LUMNIJE KASAJ

(Biblioteka Ndërkomunale "Latif Berisha", Mitrovicë)

Asnjëherë më parë në botë në dollapët e bibliotekave nuk ka pasur më tepër Libra, por njëkohësisht asnjëherë nuk ka pasur me tepër libra dhe materiale të tjera bibliotekare të dëmtuara. Prandaj të gjithë ne që punojmë në biblioteka dhe ushtrojmë veprimtarinë e bibliotekarisë, duhet të jemi të brengosur për sigurimin, ruajtjen dhe mbrojtjen e materialit bibliotekar.

Materiali bibliotekar që përdorim sot, duhet të jetë i mbrojtur dhe të ruhet si pasuri të cilën do ta trashëgojnë dhe përdorin edhe brezat e tjerë. Për t'iu shmangur dëmtimeve të këtij materiali, duhet ditur si të ruhet e mbrohet, cilat metoda mund të përdorim për ta ruajtur në gjendje të kënaqshme. Njëra prej rrugëve që mund të përdorim për sigurimin e kësaj pasurie është miratimi dhe sjellje në fuqi e ligjeve dhe rregullave në nivel nacional, me qëllim që mbrojtja e materialit bibliotekar të jetë e obligueshme. Kjo mund të arrihet vetëm atëherë kur të ekzistojë vullneti dhe përkushtimi i institucioneve për miratim të ligjeve dhe rregullave për ruajtjen dhe mbrojtjen e materialit bibliotekar, që është bazë për ekzistimin e një biblioteke.

Shumica e bibliotekave, sidomos ato të rajonit, pothuajse e kanë afërsisht të njëjtë, në përmbajtje, ligjin e bibliotekave, mbi bazën e të cilit nxirren rregullore për mbrojtjen dhe ruajtjen e materialit bibliotekar, ku përfshihen metodat për ruajtjen dhe mbrojtjen e materialit bibliotekar, duke filluar nga objekti ku është i vendosur ky material, kushtet, mënyra e përdorimit, rehabilitimi, restaurimi, përdorimet e kimikalieve të ndryshme për dezinfektim etj. Madje në disa nene përfshihet edhe mbrojtja e trashëgimisë kulturore në grupin e të cilave në bibliotekari hyjnë si koleksione të veçanta.

Kosova deri tani ka të miratuar vetëm ligjin për Biblioteka nr. 2003/6, i cili është i nivelit nacional për lëmin e bibliotekarisë, ndërsa që ende nuk e ka nxjerrë asnjë akt nënligjor që do të sanksiononte ruajtjen dhe mbrojtjen e materialit bibliotekar. Është e ngutshme dhe shumë e rëndësishme që Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve e Kosovës të nxjerrë aktet nënligjore që do të mundësonin ruajtjen më efikase dhe mbrojtjen e materialit bibliotekar, i cili është si bazë për funksionimin e bibliotekës si institucion i rëndësishëm në mbrojtje të vlerave të trashëgimisë kulturore të Kosovës; sidomos është e rëndësishme ruajtja e koleksioneve të veçanta, si: koleksionet e librit të rrallë, dorëshkrimeve, periodikut, muzikaleve, hartografisë, filmave, CD-ve, magjistraturave, doktoranturave etj.

Këto janë materiale të rralla specifike dhe shumica e këtyre materialeve u takon periudhave më të hershme kohore dhe duhet një përkushtim më i madh në ruajtjen dhe mbrojtjen e tyre. Prandaj del si domosdoshmëri miratimi i një rregulloreje të nivelit nacional në mënyrë që kjo veprimtari bazë dhe specifike të ruhet e mbrohet me akte nënligjore. Ky do ishte një element që Kosova mund t'u bashkëngjitet vendeve të zhvilluara që ka realizuar modernizimin e legjislacionit në fushën e bibliotekarisë.

Kosova duke mëtuar të jetë shtet i zhvilluar dhe bashkëkohor në të gjitha sferat e veprimtarisë edukative-arsimore duhet të investojë më shumë në kulturë dhe të ofrojë kushte për zhvillimin e bibliotekave.

Duhet të krijohen rrugët e bashkëpunimit, duke shfrytëzuar përvojën e mirë të shteteve moderne. Investimi në përgatitjen e kuadrove profesionale në fushën e bibliotekarisë, do të krijonte rrethana që ligjet e miratuara të zbatohen në mënyrë profesionale dhe me përpikëri. Është shumë me rëndësi që specialistë të bibliotekarisë në Kosovës të jenë pjesëmarrës në Konferencat Ndërkombëtare që merren me problematikat e shkencës së informacionit në përgjithësi e veçanërisht bibliotekarisë si pjesë përbërëse të kësaj fushe. Gjithashtu është shumë me rëndësi për bibliotekat e Kosovës, që të jenë prezentë në debate të ndryshme që kanë të bëjnë me legjislacionin dhe në pyetjet që kanë lidhshmëri me këtë veprimtari.

Si përfundim, do të ishte me rëndësi nisma për përmirësimin e ligjit për biblioteka dhe miratimin e akteve nënligjore, të cilat do të rregullonin veprimtarinë e bibliotekave e në kuadër të saj edhe mbrojtjen e materialit bibliotekar.

Duke u bazuar në këtë, Kosova mund të miratojë një rregullore të nivelit nacional për ruajtjen dhe mbrojtjen e materialit bibliotekar e në kuadër të së cilit hyjnë edhe Koleksionet e Veçanta.

LIBRI QË I MUNGONTE BIBLIOTEKARISË SONË

(TAHIR FONIQI: "TIPAT E BIBLIOTEKAVE NË KOSOVË", BOTOI BKUK, PRISHTINË 2008)

SYLEJMAN PIREVA

(Biblioteka Ndërkomunale "Hivzi Sulejmani" në Prishtinë)

Me botimin e librit më të ri të Tahir Foniqit, "Tipat e bibliotekave në Kosovë" fushës së bibliotekarisë iu shtua një vepër që meriton të vlerësohet pozitivisht. Kjo mund të thuhet si për tematikën, strukturën e mbarështimit, ashtu edhe për mënyrën e shtjellimit. Autori ka arritur të paraqesë një pasqyrë të qartë dhe të plotë për rrjetin e bibliotekave në Kosovë. Ai i ka vënë vetes për detyrë që të na njoftojë për formimin e bibliotekave pas Luftës së Dytë Botërore, historikut, por edhe për sfidat gjatë zhvillimit të tyre në një periudhë të caktuar që kap vitet 1944-1986, që është koha më karakteristike e gjysmës së dytë të shekullit XX; të fillimit të hapjes së bibliotekave të para në territorin e Kosovës, duke filluar me bibliotekën e sotme Kombëtare dhe Universitare të Kosovës, në shkolla, fakultete, në institucione, në ndërmarrjen etj., ku ka pasur edhe ngritje dhe rënie të tyre, varësisht prej rrethanave shoqërore-politike të kohës që i kanë përcjellë ato. Një libër si ky i ka munguar deri më sot literaturës sonë bibliotekare.

STRUKTURA E LIBRIT

Libri përbëhet prej pesë kaptinave: 1. Tipat e bibliotekave në Kosovë, 2. Struktura e koleksioneve te bibliotekave, 3. Struktura e përdoruesve (lexuesve) të bibliotekave, 4. Kuadrot bibliotekare dhe rregullimi profesional i bibliotekave, 5. Veprimtaria arsimore e kulturore e bibliotekave.

Secila prej kaptinave është e ilustruar me të dhëna, tregues të shumtë që informojnë mjaftë saktë dhe mirë lexuesin me këto biblioteka.

Renditja kësisoj e kapitullit të librit, është logjike dhe profesionale, pasi në këtë mënyrë autori ka arritur të paraqesë gjendjen e përgjithshme që kanë kaluar këto biblioteka të të gjithë tipave: numrin e tyre, infrastrukturën, strukturën e koleksioneve, strukturën e lexuesve, kuadrin dhe përgatitjen profesionale, zhvillimin e bibliotekave nëpër periudha, shkallën e profesionalizmit dhe funksionalizimit, respektivisht zhvillimin e veprimtarisë bibliotekare e kulturore të tyre dhe rolin që ato kanë luajtur në edukimin dhe arsimimin e disa brezave.

Sado që autori nuk e thotë drejtpërdrejt arsyen dhe shkaqet përse u desh të pritet fundi i Luftë së Dytë Botërore për të pasur interesim tjetër fare për hapjen dhe formimin e bibliotekave, pastaj për zhvillimin e tyre të ngadalshëm me shumë pengesa e vështirësi për disa vjet me radhë (sepse kjo s'është as tema dhe as qël-

limi i autorit për t'u marrë me këtë), megjithatë kjo mund të kuptohet prej kontekstit historik dhe politik të sistemit dhe regjimit të periudhës që merr në trajtim Foniqi.

RRUGA E ZHVILLIMIT TË BIBLIOTEKAVE

Që në parathënie të librit jepet njoftimi për rrjetin e bibliotekave në Kosovë, që nis të përhapet pas Luftës së Dytë Botërore, fondet e varfra me literaturë, për kuadrin dhe infrastrukturën, kur paraqiten bibliotekat e para në qytete, lokalitete, shkolla, fakultete, ente, ndërmarrje etj. Këtu edhe zë fill identifikimi i ngadaltë i bibliotekave që dallojnë për nga destinimi, lloji i koleksioneve dhe i kategorisë së përdoruesve. Pikërisht kjo është tema e librit që e ka zgjedhur autori dhe i ka interesuar atij. Mbase ka mundur të jetë një studim pak më i thellë rreth tipizimit të tyre më të plotë, për t'u dukur më i qartë dallimi midis tyre.

Tahir Foniqi mëton së pari të heqë dilemat në përcaktimin e datave sa më të sakta të themelimit të bibliotekave, duke u shërbyer me dokumente arkivorë, por edhe me deklaratat e personaliteteve politiko-shoqërore rreth kësaj fushe. Kjo ndodh me ndonjë bibliotekë për datën e themelimit të saj, siç është rasti me Bibliotekën Kombëtare dhe Universitare të Kosovës, duke i përmendur katër data të ndryshme dhe për të ardhur te data që është e pranueshme zyrtarisht.

Natyrisht, autori krahas kësaj, ka ofruar të dhëna edhe për sfidat që i kanë përcjellë këto institucione kulturor edhe kombëtare. Këtu Foniqi del një kronist i mirë.

Është e natyrshme, që një vend të rëndësishëm në këtë libër autori ia ka



kushtuar tipit të bibliotekave publike, jo pse ato janë më shumë në numër, sa për rolin që ljaunë në çdo kohë dhe në çdo shoqëri. Pasi konstaton se para Luftës së dytë Botërore kishte vetëm tri sosh në Kosovë, autori dokumenton për themelimin e më shumë bibliotekave nëpër disa qytete, lokalitete dhe fshatra.

Njësoj do të veprojë edhe me ndriçimin e formimit të bibliotekave shkollore, universitare (të fakulteteve), speciale etj.

HOLLËSITË STATISTIKORE

Autori i këtij libri, që është dëshmuar edhe më herët si njohës i mirë në fushën e bibliotekarisë, veçmas në fushën e bibliografisë, në këtë vepër shquhet si hulumtues i palodhshëm për të na ofruar të dhëna të hollësishme dhe të shumta statistikore, ku janë përfshirë të gjitha strukturat e tipave të bibliotekave gjatë periudhës 1944-1986: struktura e organizimit të brendshëm, struktura e kuadrit në aspektin profesional dhe nacional, struktura e përdoruesve-lexuesve në aspektin social e nacional, struktura e koleksioneve në aspektin gjuhësor dhe llojit të literaturës, kurse në BKUK dhe sipas KDU-së (Klasifikimi Decimal Universal), lloji i veprimtarisë bibliotekare dhe i aktiviteteve kulturore të tyre etj.

Përveç të tjerash, ajo që bie në sy dhe ia shton vlerën këtij libri, është literatura e shfrytëzuar nga autori dhe fusnotat që ka përdorë në fund të çdo kaptinë. Kur është fjala për fusnotat, sado që kjo formë është e pranueshme, kujtoj se do të ishte më praktike që fusnotat të jepeshin në mbarim të faqeve të librit.

Dike e përmbyllur këtë shkrim për librin e Tahir Foniqit, "Tipat e bibliotekave në Kosovë" konstatoj se literaturës sonë bibliotekare i është shtuar edhe një vepër e çmueshme, që mund të them lirisht se i ka munguar asaj deri tash.

Është kontribut që do t'u hyjë në punë të gjithë atyre që do të merren me studime të kësaj fushe, ku mund të shërbehen me të dhëna dhe informata të nevojshme për ta.

ÇFARË ËSHTË Google, SI LINDI, SI U ZGJERUA DHE KUSH E MIRËMBAN

GOOGLE, BOTA JONE E INFORMACIONIT

Kompania më e madhe në botë e internetit, Google, ka filluar punën në janar të 1996-s, së pari si një hulumtim nga Larry Page, i cili u bashkua me Sergey Brin. Të dy ishin Ph.D. studentë në Universitetin e Stanford në Kaliforni. Ata kishin shfaqur interesime për një faqe interneti që në vitin e parë të studimeve, kishin kërkuar e analizuar edhe faqe të tjera të internetit për të prezantuar një faqe unike, në të cilën mund të futeshin informacione dhe të shfrytëzoheshin ato nga kushdo, nga e gjithë bota, në çdo kohë.

Fillimisht, domeni i saj i motorkërkimit të përdorur në Stanford University ishte google.stanford.edu. Ndërsa, google.com ishte regjistruar më 15 shtator 1997, kurse kompania ishte inkorporuar si Google Inc. Investimet fillestare të ngritura për kompaninë arritën në 1.1 milion $. Pra, që në fillim, Google ecte me hapa të mbarë dhe të shpejtë.

Emri Google ka origjinë nga fjala "googol", term matematikor, e cila i referohet njëshit me njëqind zero pas.

Google është një motor kërkimi që përpunon rrjetin dhe mund të gjejë pamje, foto, newsgroup, lajme, harta dhe video dhe mund të mbajë një kopje të të gjitha faqeve që ajo njeh. Nëpërmjet Google-s ju mund të konvertoni valutë me të gjitha paratë e botës. Gjithashtu, Google kryen dhe veprime matematike. Për të bërë një kërkim në Google mjafton të shkruani në kuadratin e kërkimit disa fjalë të asaj që ju po kërkoni, dhe në pak sekonda Google ju shfaq rezultatet e kërkimit të saj. Shumë shërbime të veçanta për motorin e kërkimit mund t'i gjeni në adresën labs.google.com. Kur Google u krijua, shumë uebmasterë filluan të shpjegonin dhe punonin për të në mënyrë të tillë që uebsajtet e tyre të zinin vend në kërkimet e Google-s.

Suksesi i kompanisë Google u tregua shumë shpejt, pasi filloi shitjen e reklamave nga reklamuesit e saj në gazeta dhe revista offline. Google u bë shefe edhe e shumë shërbimeve. Bleu radio, reklama të firmave e të gazetave të ndryshme amerikane. Madje, në fund të vitit 2006 e bleu shërbimin YouTube për $ 1.65 miliardë. Në tetor të 2006-s Google njoftoi se kishte fituar JotSpot, një zhvillues i teknologjisë për bashkëpunim të uebsajteve. Ndërsa më 13 prill 2007 Google kishte arritur një marrëveshje për të marrë DoubleClick. Me të Google ra dakord për të blerë kompaninë për 3.1 miliardë $. S'u ndal me kaq. Bleu më 2 korrik 2007, GrandCentral Google, për 50 milionë $.

Në vitin 2008 Google njoftoi se ishte duke pritur një arkiv të revistës Jeta e fotografive, si pjesë e një përpjekje të përbashkët. Disa nga imazhet në arkiv nuk kanë qenë asnjëherë të botuar në revistë.

Për vitin fiskal 2006, kompania raportoi 10,492 miliardë $ në total të ardhurat nga reklamat dhe vetëm 112 milionë $ në të ardhurat e licensimit dhe të tjera.

E jashtëzakonshme sot është se, Google përdor rreth 450 000 kompjuterë GNU/Linux për t'iu përgjigjur kërkesave dhe për ta përpunuar rrjetin. Falë kësaj fuqie në kryerjen e veprimeve, Google është në gjendje të bëjë një kërkim në miliona faqe interneti në pak milisekonda dhe, gjithashtu, të bëjë shumë pasqyra në shumë serverë.

Shumë organizata akuzuan Google për sa i përket së drejtës së autorit. Google hoqi menjëherë nga kërkimi ato faqe interneti që cenuan të drejtën e autorit. Në vitin 2006 shumë universitete amerikane i kërkuan Google t'i bllokojë nga kërkimi të gjitha faqet e internetit që shisnin ese dhe detyra të gatshme pasi shumë studentë i blinin ato duke i kërkuar nëpërmjet motorit të kërkimit të kësaj kompanie. Google s'u ndal me kaq. Search-i i saj ende vazhdon...

Përgatiti: Liridon Zekaj,
zyrtar i IT-së në BKUK

AMBASADORI I AUSTRISË NË PRISHTINË VIZITON BKUK-në

Prishtinë, 2 shkurt 2010

Drejtori i Bibliotekës Kombëtare dhe Universitare të Kosovës - dr. Sali Bashota priti në një vizitë zyrtare Ambasadorin e Austrisë në Kosovë - Dr. Walter Maria Stojan. Në këtë takim ishte edhe Prof. dr. Johann Gunther, ekspert i Arsimit të Lartë nga Austria.

Drejtori i BKUK-së e njoftoi Ambasadorin me punën, aktivitetet dhe të arriturat e Bibliotekës Kombëtare dhe Universitare të Kosovës.

Në këtë takim u bisedua për format e bashkëpunimit dhe të ndihmës që mund të japë Ambasada Austriake në Prishtinë, në përkrahje të aktiviteteve dhe punës profesional në biblioteka, sidomos në mundësitë për zhvillimin e programit Aleph 500 në BKUK, duke pasur parasysh se edhe Biblioteka Nacionale e Austrisë punon me të njëjtin program.

Drejtori i BKUK-së - Sali Bashota me Ambasadorin e Ambasadës Austriake - Walter Maria Stojan

Ambasadori Walter Maria Stojan shprehu gatishmërinë për përkrahje dhe angazhim, për mundësinë e dërgimit të ekspertëve austriakë në Kosovë, të cilët do të ndihmonin në fusha të veçanta të bibliotekarisë.

Në kuadër të projekteve të përbashkëta, u diskutua edhe për aktivitetet e Bibliotekës Austriake të Fakultetit të Filologjisë dhe mundësinë e përfshirjes së kësaj biblioteke në rrjetin e Programin të automatizuar bibliotekar Aleph 500, i cili funksionon në BKUK.

Drejtori Bashota i është falënderuar Ambasadorit për vullnetin e mirë për të ndihmuar dhe përkrahur proceset e zhvillimit të BKUK-së.

Durim Hasaj

ProCredit Bank NDIHMON BKUK-në

Prishtinë 5 shkurt 2010

Biblioteka Kombëtare dhe Universitare e Kosovës nënshkroi një Memorandum Mirëkuptimi me ProCredit Bank, me seli në Prishtinë, me ç'rast kjo e fundit ka dhënë një donacion në vlerë 23 mijë euro për renovimin e Qendrës së Trajnimeve të Bibliotekës Kombëtare dhe Universitare të Kosovës dhe për pasurim të fondeve të kësaj biblioteke.

Renovimi i kësaj qendre, nëpërmjet kompjuterizimit dhe pajisjes me mjetet më bashkëkohore, do të ngritë cilësinë e kushteve për aftësimin e punonjësve të bibliotekave.

Një pjesë e donacionit do të shfrytëzohet për të ndërtuar fondin e librave për ekonomi, të cilat do të ekspozohen si fond i hapur i bibliotekës, ku përdoruesit mund t'i shfrytëzojnë me lehtësi.

Akti i nënshkrimit të Memorandumit të Mirëkuptimit me ProCredit Bank

Drejtori i BKUK-së - dr. Sali Bashota, e ka vlerësuar këtë donacion të ProCredit Bank, si një kontribut të çmueshëm për bibliotekën në fazën e procesit të krijimit e të avancimit të kushteve për zhvillim të kuadrit nga fusha e bibliotekarisë.

Ndërsa, drejtori gjeneral i ProCredit Bankës - Philip Sigwart, ka pohuar se me rastin e 10-vjetorit të themelimit të bankës, është vendosur të ndihmohet BKUK-në me këtë donacion, ku, siç tha ai, një pjesë do të shkojë në rregullimin e qendrës së trajnimeve, ndërsa pjesa tjetër e donacionit në blerjen e librave nga fusha e ekonomisë.

Durim Hasaj

JAVA E BIBLIOTEKËS NË KOSOVË = LIBRARY ËEEK IN KOSOVA : 14 – 18 PRILL = APRIL, 2009, PRISHTINË, BIBLIOTEKA KOMBËTARE DHE UNIVERSITARE E KOSOVËS, 2010, 109 F.

Botimi i shtatë, që është në radhën e botimeve të veçanta të përçdovitshme, është përmbledhje e punimeve nga fusha e bibliotekarisës, të cilat janë lexuar nga autorë interesimesh të ndryshme nga kjo fushë, gjatë manifestimit tradicional Java e Bibliotekës në Kosovë 2009.

Këto shkrime, në këtë, botim jepen ashtu si janë prezantuar nga autorët gjatë Javë së Bibliotekës - si punime të plota ose në formë të abstrakteve.

Botimi përfshin punime që trajtojnë probleme bibliotekare në nivel teorik e empirik - sipas interesimeve e njohjeve nga bibliotekarë e ekspertë nga kjo fushë.

Në këtë botim përfshihen ligjëratat e z. Kenneth Oberembt, specialist për zhvillimin e Bibliotekave nga ShBA dhe ish-drejtor i Bibliotekës Kombëtare dhe Universitare të Kosovës, të cilat kanë zgjuar interesim në opinionin e gjerë bibliotekar, si ligjërata që lidhet me projektin më të cilin është marrë ky autor: Plani Strategjik për Bibliotekën Kombëtare dhe atë Universitare, si dhe ligjëratat me interes për bibliotekarët në kontekstin tonë: ,,Nëntë parimet e partneritetit të bibliotekave" dhe ,,Kremtimi i bibliotekave të vogla që kanë plane të mëdha".

Ky botim përfshin edhe ligjërata që janë mbajtur nga seanca të veçanta, si e ajo e Tahir Foniqit: ,,Bibliografia - Historia, definicionet", Bedrije Mekollit: ,,Ruajtja dhe konservimi i materialeve bibliotekare dhe arkivore", Muharrem Halilit: "Historia e dokumenteve të vjetra historiografike dhe vlera e përshkrimit të informacionit të tyre", si dhe e Bukurije Halitit: Programi i automatizuar Aleph 500 dhe perspektiva e zgjerimit të tij në Kosovë.

Në këtë botim janë përfshirë edhe ligjëratat nga seanca "Biblioteka dhe Shkolla", të njohësve dhe udhëheqësve të bibliotekave nga Kosova, si: Engjëll Berishës, Sylejman Pirevës, Arjeta Sadikut, Lumnije Kasës, Shqipe Shalës dhe Adil Ollurit.

SYLEJMAN PIREVA, BIBLIOTEKA PUBLIKE DREJT REFORMAVE, KONICA, PRISHTINË, 2009, 209 F.



Ky autor, i cili ka një përvojë shumëvjeçare në fusha të veçanta të bibliotekarisë dhe në ato të menaxhimit dhe zhvillimit të bibliotekave, paraqitet me botimin "Biblioteka publike drejt reformave", që është një përmbledhje e shkrimeve të këtij autori, shumica e të cilave janë të botuat në gazeta të përditshme të Kosovës, si dhe në revista të veçanta të fushës së bibliotekarisë. Këtu, gjithashtu, përfshihen edhe shkrime të autorit, me të cilat është prezantuar në konferenca dhe seminare të ndryshme për bibliotekat dhe bibliotekarinë.

Ky botim përfshin shkrime që janë botuar apo shkruar brenda një periudhe njëzetvjeçare, ku trajtohen shumë çështje që lidhen me probleme reale të bibliotekave në kontekstin e aktualitetit në Kosovë, por edhe me çështje që janë të natyrës ekskluzivisht bibliotekare.

Pra, libri përfshin një larmi temash, si ato që lidhen me bibliotekën, si faktor i rëndësishëm i arsimimit, statusi i bibliotekave në shoqëri dhe ndikimet e politikave qeverisëse në to, pastaj funksionaliteti dhe raporti mes bibliotekave publike dhe Bibliotekës Kombëtare, deri të çështje kompleksi si ato të zhvillimit dhe menaxhimit të koleksioneve, pasurimin dhe spastrimin e fondeve etj.

Autori, në një seri shkrimesh, trajton edhe probleme që lidhen drejtpërdrejt me punën e tij si udhëheqës i Bibliotekës Ndërkomunale "Hivzi Sylejmani" të Prishtinës, si dhe sfidat me të cilat është përballë, në projektet për zhvillimin e saj.

Ky libër është i një rëndësie të veçantë për bibliotekarët dhe opinionin tonë kulturor, meqë përmban të dhëna, informacion të rëndësishme, si dhe qasje për probleme të ndryshme nga një perspektivë origjinale dhe e veçantë.

Bukurije HALITI